



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 548 Akti

Nr. 682 Vendim
Tiranë, më 10.7.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datat 6.7.2023 dhe 10.7.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Enklid Gjini**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneres Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Enklid Gjini, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Enklid Gjini është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Enklid Gjini do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Firdes Shuli dhe Olsi Komici. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

3. Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, sot Autoriteti Kombëtar i Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

4. Me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Xhensila Pine. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti nuk është shprehur mbi ndonjë gjendje konflikti interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 7.6.2023, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ dhe vendimmarrja të bazohet në të tria kriteret, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

6. Në datën 15.6.2023, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 3.7.2023; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, në datën 5.7.2023 u administrua në rrugë elektronike një denoncim nga publiku dhe pas verifikimit u konstatua se për të njëjtin shkak ishte paraqitur një denoncim i mëparshëm, i verifikuar nga Komisioni për të cilin subjektit i janë kërkuar shpjegime me njoftimin e rezultateve të hetimit.

8. Në datën 3.7.2023, subjekti i rivlerësimit dërgoi përmes postës zyrtare parashtrimet e tij dhe dokumentacionin shoqëruar mbi rezultatet e hetimit administrativ, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 3.7.2023.

9. Me vendimin nr. 3, datë 3.7.2023, trupi gjykues vendosi kalimin e çështjes në seancë dëgjimore dhe caktimin e seancës dëgjimore për në datën 6.7.2023.

10. Në datën 6.7.2023 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

11. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që

të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

12. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

13. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

14. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45, 46, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga AKSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe çdo informacion i marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinione të vëzhguesit të ONM-së sipas pikës 11 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

Vlerësimi i pasurisë

15. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Enklid Gjini ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë në datën 25.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me nr. indeksi ***, ka dorëzuar sipas ligjit deklaratën përpara fillimit të detyrës (në vijim DPDF) në vitin 2003 dhe në vijim ka dorëzuar rregullisht deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV).

16. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, dhe në përfundim të veprimeve verifikuese, ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

17. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1 të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Enklid Gjini, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016.

18. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të

lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruara në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit

19. Pasuria *apartament 2+1, me sip. 76.10 m², lagjja “****”, godina ***, hyrja ***, ap. ***, Fier. Burimi: privatizimi i banesave shtetërore. Pjesa në %, 1/3 me prindërit. ILDKPKI-ja në lidhje me këtë pasuri nuk ka konstatuar problematika.*

20. Nga aktet e dosjes¹ rezultoi se kjo pasuri është përfituar me kontratën për privatizimin e banesës të datës 22.6.1993 nga shtetasi P. Gj. (babai i subjektit), në vlerën 21.375 + 2.405 lekë. Sipas gjendjes familjare të vitit 1992, subjekti kishte mbushur moshën 18 vjeç dhe si bashkëpronar ka deklaruar pasurinë saktësisht në deklaratën për vitin 2003. Subjekti informoi dhe dokumentoi² se ky apartament është shitur nga bashkëpronarët Gj.³ në datën 17.11.2021. FSHU-ja⁴ dhe UK Fier⁵ konfirmuan kontratat përkatëse në emër të shtetasit P. Th. Gj. Në përfundim të hetimit administrativ nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

21. Pasuria *apartament 2+1, me sip. 88.5 m², Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, ndërtesa ***, hyrja ***, ap. ***. Vlera: 40.000 euro. Kësti I – 10.000 euro, paguar datë 20.11.2002 – burimi: dhuratë nga N. Gj. (gjyshja) nga shitje pasurish të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., viti 2001 dhe qira ish-****, Rruga e ***, Tiranë; kësti II – 8.000 euro paguar datë 12.3.2003; kësti III – 9.000 euro paguar datë 14.11.2003; kësti IV – 3.000 euro paguar datë 1.3.2004; kësti V – 4.500 euro paguar datë 3.11.2004; kësti i fundit 5.500 euro datë 6.5.2005 – burim të ardhurat nga pagat për vitet 1996 – nëntor 2003, një pjesë e të cilave kanë qenë depozita në BKT, Alpha Bank e bono Banka e Shqipërisë, si dhe kursime nga pagat viti 2004 e 2005. Regjistruar në ZVRPP-në Tiranë datë 12.5.2005, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.5.2005. Pjesa takuese 50%, e regjistruar në emër të shtetasve Enklid dhe Z. Gjini.*

ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.

22. Në lidhje me mënyrën e krijimit të pasurisë nga aktet në dosje⁶, rezultoi se:

- Sipas kontratës së kaparit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.3.2004, z. Enklid Gjini i ka dhënë shoqërisë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administratori A. L., kapar në shumën 30.000 euro, për blerjen e një apartamenti me sip. 96.5 m², 2+1, me çmimin 40.000 euro, që do të përfundojë në një periudhë të mëvonshme.

- Kjo pasuri është deklaruar saktësisht në deklaratën e vitit 2003, me të njëjtin çmim, sipërfaqe, dhe burim si në deklaratën *Vetting*.

- Me kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.5.2005, shtetasit Enklid Gjini dhe Z. Gj. kanë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., pasurinë nr. *** me sip. 88.5 m² dhe 8 m² ambient i përbashkët, me çmim shitjeje 40.000 euro, shumë e cila është derdhur në favor të palës shitëse, jashtë zyrës noteriale, përpara hartimit të kontratës së

¹ Shihni aktet në aneksin *** dhe *** në dosjen e ILDKPKI-së.

² Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

³ Pas lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit P. Gj., bashkëpronarë të këtij apartamenti ishin: subjekti, vëllai i tij K. Gj. dhe nëna S. Gj.

⁴ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.6.2021 dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.2.2022 nga FSHU-ja, në dosjen e Komisionit.

⁵ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.12.2022 nga UK Fier, në dosjen e Komisionit.

⁶ Shihni aktet në aneksin *** dhe ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

shitblerjes. Në regjistrin hipotekor me nr. ***, z.k. ***, datë 12.5.2005, në emër të shtetasve Enklid Gjini dhe Z. Gj. figuron e regjistruar pasuria nr. ***.

- Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti edhe në DPV-në e vitit 2005, duke deklaruar edhe likuidimin e shumës prej 5.500 euro, si detyrim i mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k.

- ASHK Tirana Jug⁷ informoi se në bashkëpronësi të shtetasve Enklid Gjini dhe Z. Gj. rezulton e regjistruar pasuria nr. ***, apartament me sip. 88.5 m². FSHU-ja⁸ nuk ka konfirmuar kontratë të furnizimit me energji elektrike. Pas kërkesës së Komisionit, subjekti paraqiti vërtetim të lëshuar nga FSHU-ja sipas të cilit z. Enklid Gjini është abonent me kontratën me kod ***, ku vihet re se pagesat nisin që nga muaji janar i vitit 2007. UKT-ja⁹ ka konfirmuar në emër të subjektit Enklid Gjini kontratën e furnizimit me ujë nr. ***, me adresë në rrugën “****” (rruga “****” ndodhet tek zona e ***).

23. Në lidhje me mënyrën e likuidimit të çmimit të blerjes së pasurisë, u evidentua se:

- Deri në datën e lidhjes së kontratës së kaparit 1.3.2004, është likuiduar shuma prej 30.000 euro. Ndërsa shuma e mbetur prej 10.000 euro është likuiduar deri në datën e lidhjes së kontratës së shitjes 6.5.2005. Kjo mënyrë likuidimi konfirmohet edhe nga deklaratimet e subjektit në deklaratën *Vetting*, DPV-të e viteve 2004 dhe 2005.

- Për të provuar deklaratimet e tij mbi likuidimin e çmimit të blerjes, subjekti ka paraqitur¹⁰: (i) mandatarkëtimin nr. ***, datë 10.11.2002, për shumën 10.000 euro; (ii) mandatarkëtimin nr. ***, datë 12.3.2003, për shumën 8.000 euro; (iii) mandatarkëtimin nr. ***, datë 14.11.2003, për shumën 9.000 euro; (iv) mandatarkëtimin nr. ***, datë 1.3.2004, për shumën 3.000; (v) mandatarkëtimin nr. ***, datë 3.11.2004, për shumën 4.500 euro; (vi) mandatarkëtimin nr. ***, datë 6.5.2005, të shumës 5.500 euro, me përshkrimin “Likuidim përfundimtar apartamenti 2+1”. Nga këto mandatarkëtime vihet re se çmimi i blerjes prej 40.000 euro është likuiduar nga subjekti *cash* në arkën e shoqërisë.

- Në të gjitha DPV-të subjekti ka deklaruar detyrimet financiare të mbetura të pashlyera. Konkretisht: (i) në DPFD-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar detyrimin e mbetur shoqërisë “****” sh.p.k. në shumën 13.000 euro me sqarimin se: “Kësti 27.000 euro është paguar në nëntor 2003, kontrata e sipërmarrjes është lidhur më 1.3.2004 me nr. *** rep., nr. *** kol.” (nisur nga data dhe ekstremitetet e kontratës që deklarohen nga subjekti, rezulton se bëhet fjalë për kontratën e kaparit); (ii) në DPV-në e vitit 2004 subjekti ka deklaruar si detyrim të shlyer ndaj shoqërisë gjatë atij viti shumën prej 7.500 euro dhe si detyrim të papaguar shumën prej 5.500 euro.

- Siç vihet re, ka një pasaktësi në deklarin e subjektit të vitit 2003 ku ai deklaroi se kësti 27.000 euro është paguar në nëntor 2003, ndërkohë që nga dokumentet e paraqitura rezultoi se kjo shumë është paguar deri në nëntor të vitit 2003. Në parashtrimet e tij, subjekti u shpreh se deklarimi i tij në DIPFD-në e vitit 2003 se “kësti 27.000 euro është paguar në nëntor 2003” duhet të ishte “kësti 27.000 euro është paguar deri në nëntor 2003” dhe ky është lapsus, pasi në atë periudhë ka konsideruar se pagesa ose jo e të gjithë shumës 27.000 euro në nëntor 2003, nuk do të sillte asnjë ndryshim në rezultatin financiar të vitit 2003. Këto sqarime vlerësohen bindëse, pasi pagesa e shumës 27.000 euro brenda vitit 2003 vërtetohet me mandatpagesat, të cilat janë prova shkresore të paraqitura nga subjekti në ILDKPKI.

24. Sipas udhëzimit nr. 3, datë 16.10.2002, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “k””, vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave për qytetin e

⁷ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 7.7.2021 nga ASHK Tirana Jug, në dosjen e Komisionit.

⁸ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 8.6.2021 nga FSHU-ja, në dosjen e Komisionit.

⁹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.6.2021 nga UKT-ja, në dosjen e Komisionit.

¹⁰ Shihni aktet në aneksin ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

Tiranës, është 46.574 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi. Çmimi i referencës për apartamentin objekt verifikimi rezulton 46.574 lekë/m² x 96.5 m², në total 4.494.391 lekë ose 32.805 euro sipas kursit të kohës, pra rezulton se apartamenti nuk është blerë më lirë se çmimi i referencës. Nga verifikimet e kryera në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi, nga të dhënat e marra nga Prokuroria e Rrethit Tiranë¹¹ dhe Fier¹² nuk rezultuan çështje të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe administratorin e saj A. H. L.

25. Sa i takon burimit të krijimit të pasurisë u evidentua se: (i) për shumën prej 10.000 euro ka deklaruar “Dhuratë nga N. Gj. (gjyshja)” me burim të ardhura nga shitja me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., viti 2001 dhe të ardhura nga qiratë e ish-***; (ii) për shumën prej 30.000 euro ka deklaruar të ardhura nga pagat për vitet 1996 – nëntor 2003, një pjesë e të cilave kanë qenë depozita në BKT, Alpha Bank e bono në Bankën e Shqipërisë, si dhe kursime nga pagat viti 2004 e 2005.

Analizë specifike e secilit prej burimeve

26. Në lidhje me burimin “Dhuratë nga gjyshja”, në deklaratën e vitit 2003 si OPGJ e gjatë procesit¹³ subjekti ka deklaruar dhuratë nga N. Gj. (gjyshja) në shumën 10.000 euro si një ndër burimet e krijimit të pasurisë objekt verifikimi, marrë që në nëntor 2002. Për të vërtetuar marrëdhënien e posaçme dhe të ngushtë me gjyshen, në përgjigje të pyetësorit standard, nëpërmjet deklarimeve të detajuara, subjekti i referohet disa fakteve e rrethanave të dokumentuara edhe me akte shkresore, trajtuar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ. Ndonëse nuk ka një dokument që të konfirmojë vullnetin e gjyshes së subjektit N. Gj. për dhurimin e shumës prej 10.000 euro nipit të saj në vitin 2002, referuar marrëdhënies së ngushtë me gjyshen, të cilën subjekti e ka përfaqësuar nëpërmjet disa prokurave të administruara nga Komisioni, ndërkohë që ka qenë i përfshirë si një nga trashëgimtarët edhe në testamentin e lënë prej saj, si dhe faktit që në deklaratën për vitin 2003 si OPGJ subjekti ka deklaruar dhuratën prej 10.000 euro, deklarimi i subjektit për dhurimin e shumës 10.000 euro konsiderohet i besueshëm.

27. Analizë e secilit prej burimeve që kanë krijuar shumën 10.000 euro

27.1. Sa i takon të ardhurave nga shitja e pasurisë me kontratë shitjeje të vitit 2001, ka rezultuar se:

- Me dëshminë e trashëgimisë nr. ***, datë 1.11.1993, janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të radhës së tretë të Dr. S. S. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 1.11.1993, trashëgimtarja N. Gj., gjyshja e subjektit, ka përfituar pasuritë e trashëguara të trashëgimlënësit në pjesën e saj takuese 1/8 e 1/3 = 1/24. Ndërsa me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 2.7.1996 trashëgimtarja N. Gj. ka përfituar pasuritë e trashëguara të trashëgimlënësit S. S. në pjesën e saj takuese 1/8 e 1/6 = 1/48 pjesë.

- Sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., viti 2001, pala shitëse, trashëgimtarët e shtetasit S. S. (gjithsej 34 bashkëpronarë), ndër të cilët përfshihet edhe shtetasja N. Gj., i shesin shoqërisë “****” sh.p.k. një sipërfaqe trualli prej 1.102 m² dhe ndërtesë 1 kat e ngritur mbi këtë truall, pronë e cila figuron në emër të palës shitëse sipas vërtetimit të pronësisë datë 17.4.2001, me çmim shitjeje 320.000 USD. Sipas kësaj kontrate, pagesa do të bëhet në dy depozitime në llogaritë bankare të shitësve K. G. dhe K. S. (përfaqësues me prokurë) në bankën Alpha Kredit.

¹¹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.4.2023 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

¹² Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 31.3.2023 nga Prokuroria e Rrethit Fier, në dosjen e Komisionit.

¹³ Shihni aktet në aneksin *** dhe ***, në dosjen e ILDKPKI-së; përgjigjet e pyetësorëve nr. 1, nr. 2 dhe dokumentacionin bashkëngjitur tyre, në dosjen e Komisionit.

- Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se nga kjo shumë gjyshja e tij ka përfituar 1/48 pjesë, pra 6. 666 USD, e cila përbën 1/48 pjesë.

- Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka informuar se të ardhurat nga shitja janë derdhur në llogaritë bankare të shtetasve K. G. dhe K. S., përfaqësues me prokurë të shitësve, në bankën Alfa Credit, dhe për këtë shitje janë paguar detyrimet tatimore pasi prona ka kaluar në favor të blerësit. PAGESA E DETYRIMIT TATIMOR VËRTETOHET ME MANDATARKËTIMIN DATË 27.7.2001, DERDHUR NË ARKË 9.628 USD, E KONVERTUAR 1.380.480 LEKË “pagesë 3% të vlerës së shitjes” me përshkrimin “Derdh taksë kalimi pronësie 3% e vlerës së shitjes”.

- Subjekti ka informuar gjithashtu se të ardhurat nga shitja janë derdhur në llogarinë e trashëgimtarëve të Dr. S. në bankën Alfa Kredit dhe janë tërhequr nga shtetasi J. V., përfaqësues me prokurë nga N. Gj., shumë të cilën ky i fundit ia ka dhënë dorazi gjyshes së subjektit. Në mbështetje të këtij pretendimi subjekti ka paraqitur prokurën e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.5.2001, sipas së cilës 6 trashëgimtarë të Dr. S., ndër të cilët gjyshja e subjektit N. Gj., kanë autorizuar shtetasin J. V. si përfaqësuesin e tyre ligjor për të kryer veprime në lidhje me pasuritë e trashëguara prej tyre.

- Me qëllim verifikimin e deklarimeve të subjektit dhe kontratës së shitblerjes lidhur me llogaritë bankare ku depozitoheshin të ardhurat nga shitja, gjatë hetimit administrativ me kërkesë të Komisionit, OTP Bank¹⁴ konfirmoi se shtetasit K. S., K. G. dhe subjekti “****” sh.p.k. me NIPT *** kanë pasur llogari bankare pranë Alpha Bank Albania, ndërsa J. V. nuk ka pasur llogari. Sipas ekstrakteve të llogarive bankare, vërehet se shoqëria “****” sh.p.k. ka transferuar në llogarinë e shtetasit K. G. shumën prej 320.000 USD gjatë periudhës 13.8.2001 – 27.9.2001, të cilat kanë përshkrimin “Kaluar nga “****” sh.p.k. për K. G. (blerje truall tek Rruga e ***). Këto fonde në vijim janë tërhequr *cash* ose transferuar shuma në vlerën prej afërsisht 307.000 USD. Sipas ekstraktit të llogarisë së shtetasit K. G., në datën 14.8.2001 është bërë një tërheqje *cash* në vlerën 6.459 USD me përshkrimin “Tërheqje K. G. **** (për J. V.)”.

- Bazuar në të dhënat si më sipër, përputhen deklaratimet e subjektit me të dhënat e administruara dhe, për rrjedhojë, shuma prej 6.600 USD është konsideruar si e ardhur e ligjshme që ka shërbyer si një pjesë e dhuratës nga gjyshja në vlerën 10.000 euro.

27.2. Sa i takon të ardhurave nga qiratë e ish-****, Rruga e ***, Tiranë, rezultoi se:

- Referuar vërtetimit nga dokumentet hipotekore me datë lëshimi 22.7.2003, në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 24.10.1996, në emër të 34 bashkëpronarëve, ndër të cilët edhe N. Gj., është e regjistruar pasuria “truall me sip. 2869 m², mbi të cilin është ndërtuar një godinë trekatëshe (***)”.

- Janë administruar 3 kontrata qiraje të viteve 1995, 2000 dhe 2002, të lidhura mes trashëgimtarëve të S. S. dhe Ambasadës së Francës në Tiranë për dhënien me qira të vilës dhe të kopshtit të zënë aktualisht nga ***, nr. ***, rruga “****”/ Rruga e ***, nr. ***, për një periudhë kohore përkatësisht prej 5 vitesh, 3 vitesh, 3 vitesh, me qira mujore përkatësisht 7.338 USD, 9.000 USD dhe 9.000 USD. Në lidhje me mënyrën e pagesës së qirasë kontratat parashikojnë se ajo do të derdhet çdo tre muaj në llogari bankare që do të caktohet me marrëveshje mes palëve/llogarinë e hapur pranë Bankës Amerikane nga z. M. K. në emër të trashëgimtarëve të Dr. S. S., llogarinë e hapur pranë Bankës Amerikane nga K. G. në emër të trashëgimtarëve të doktor S.

- Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar¹⁵ se për periudhën 1.1.1995 – qershor 1996 gjyshja e tij ka përfituar 5.503 USD. Për periudhën korrik 1996 – 2000, kur përfundonte

¹⁴ Shihni shkresën kthim përgjigjeje të OTP Bank nr. *** prot., datë 31.3.2023 dhe shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2023, në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

kjo kontratë ka përfituar 6.420 USD (pjesa e saj takuese ka qenë 1/24). Pra, në total nga kjo kontratë qiraje N. Gj. ka përfituar shumën 11.924 USD. Ndërsa sipas kontratës së qirasë të lidhur për një periudhë prej 3 vitesh duke filluar nga 1 janari 2000, me qira mujore 9.000 USD, ku pjesa takuese e N. Gj. ka qenë 1/48 pjesë, për periudhën 1.1.2000 – tetor 2002 ka përfituar 6.375 USD.

- Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave nga qiraja, rezultoi se:

a. Kontratat nuk parashikojnë detyrimin e pagesës së tatimit mbi të ardhurat nga qiraja. Komisioni kërkoi të dhëna nga DRT Tiranë në lidhje me pagesën e tatimit mbi qiratë dhe ky institucion informoi se në lidhje me pagesat jashtë sistemit tatimor për periudhën 1995 – 2004 nuk disponohen pagesa të kryera nga ana e Ambasadës Franceze¹⁶, subjekt juridik me NIPT ***.

b. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 subjekti ka informuar se të ardhurat nga qiraja e godinës së Ambasadës Franceze janë derdhur gjithmonë në bankë, pra fillimisht në llogarinë e trashëgimtarëve të Dr. S. në emër të shtetasit M. K., dhe më pas, në llogarinë e trashëgimtarëve të Dr. S. në emër të shtetasit K. G., në BKT, në Bankën e Kursimeve dhe në Bankën Amerikane të Shqipërisë, parashikime këto të bëra në nenin 7 të kontratës së qirasë të viteve 1995 – 2000 dhe në nenin 7 të kontratës së qirasë të viteve 2000 – 2003. Pasi shumat derdeshin në bankë në llogarinë e hapur për këtë qëllim, këta shtetas ua jepnin *cash* trashëgimtarëve sipas pjesëve takuese të gjithsecilit. Subjekti ka informuar se të dy këta shtetas kanë ndërruar jetë dhe se është në pamundësi objektive për të marrë informacion për llogarinë bankare të hapur në emër të tyre me qëllim pagesën e qirasë.

c. Për të vërtetuar deklaratimet e subjektit nga Komisioni u kërkuan të dhëna nga:

i) Raiffeisen Bank e cila konfirmoi se shtetasi K.G. ka qenë klient i bankës, por pas vitit 2005¹⁷;
ii) BKT-ja¹⁸ e cila konfirmoi se shtetasi K. G. ka qenë klient i bankës. Nga ekstraktet bankare të llogarive të tij verifikohen veprime individuale, pra që nuk lidhen me veprime si përfaqësues i trashëgimtarëve të Dr. S.;

iii) ISP Bank¹⁹ e cila ka informuar²⁰ se shtetasi K. G. ka pasur llogari pranë kësaj banke në monedhën dollar, me nr. ***, ndërsa shtetasi M. K. ka qenë firmë e vlefshme deri në datën 20.4.2001. Llogaria ka emërtim “K. G./përfaq. trash. Dr. S.”. Nga ekstrakti i llogarisë, vihet re transferimi fillimisht i shumës 80.900 USD në datën 19.10.2000 urdhëruar nga Ambasada Franceze me detaje të pagesës: “Muaji janar – shtator”. Në vijim, përveç kësaj pagese në bazë tre mujore, nga data 11.1.2001 – 24.1.2006 janë transferuar shumat prej 26.959.50 USD (8.986.50 USD/muaj), nga të cilat deri në datën 30.11.2002 (data e pagesës së kështit të parë të apartamentit me sip. 88.5 m²) janë transferuar 8 pagesa prej 26.959.50 USD (ose 215.676 USD) nga Ambasada Franceze. Pas çdo transferimi të këtyre shumave (përfshirë dhe transfertën fillestare në datën 19.10.2000), kanë vijuar tërheqje *cash* nëpërmjet pagesave të çeqeve bankare trashëgimtarëve të Dr. S. (siç identifikohen nga përshkrimet e veprimeve në llogari), ndër ta dhe tërheqje nga z. Enklid Gjini. Në total për periudhën 30.10.2000 – 22.2.2006 është tërhequr *cash* shuma prej 12.536 USD; ndërsa në periudhën 30.10.2000 – 30.11.2002 (kur është paguar kësti i parë i blerjes së apartamentit) është tërhequr shuma prej 5.745 USD.

- Nga të gjitha sa më sipër, vërtetohet pagesa në rrugë bankare e qirave nga Ambasada Franceze për periudhën 2000 – 2002 në favor të trashëgimtarëve të Dr. S., si dhe, përfitimi i shumës prej

¹⁶ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.4.2023 dhe shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2023 nga DRT Tiranë, në dosjen e Komisionit.

¹⁷ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.4.2023 nga Raiffeisen Bank, në dosjen e Komisionit.

¹⁸ Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.4.2023 nga BKT-ja, në dosjen e Komisionit.

¹⁹ ISP Bank ka përthithur Bankën Amerikane në vitin 2007.

²⁰ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.3.2023, shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.4.2023 të Intesa Sanpaolo Bank, në dosjen e Komisionit.

5.745 USD nga gjyshja e subjektit, tërhequr nga subjekti i rivlerësimit në periudhën 30.10.2000 – 30.11.2002, por, nuk vërtetohet pagimi i tatimit mbi të ardhurat nga qiratë. Në përfundim të hetimit administrativ, shuma 5.745 USD (pjesë përbërëse e shumës 10.000 euro dhuruar subjektit nga gjyshja e tij) u konsiderua si e ardhur e ligjshme, referuar qëndrimin të Kolegjit në vendimin nr. 15/2021, i cili orienton Komisionin që vlerësimi i të ardhurave për të cilat nuk vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore, duhet të bëhet në raport me rrethanat si: “... *Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Së dyti, në konsideratë të organeve të rivlerësimit duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtij kriteri do të duhet të vlerësohen rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie apo një qëllim për t’u arritur...*”.

Nën dritën e këtij orientimi në vlerësimin e tij, Komisioni ka mbajtur në konsideratë faktet dhe rrethanat e poshtëshënuara:

i) sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe në referencë të përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve²¹, sipas së cilës “*Në rast se qiramarrësi është person juridik, ... (rezident tatimor në Shqipëri)... dhe që bën pagesë të qirasë, mban në burim (në momentin e pagesës) tatimin mbi qiranë dhe ka detyrimin ta paguajë atë në organin tatimor*”, detyrimi për pagesën e tatimit mbi qiratë nuk ka qenë i gjyshes së subjektit si një prej qiradhënësve.

ii) nga hetimi administrativ është provuar bindshëm përfitimi i të ardhurave nga qiratë nga trashëgimtarët e Dr. S., ndër ta edhe gjyshja e subjektit, në kohën e krijimit të tyre, të paktën për periudhën 2000 – 2006;

iii) nuk u evidentua asnjë sjellje e subjektit që të ketë lidhje me pagesa të qirave nga pala qiramarrëse, dhe ai nuk rezulton të ketë qenë i përfshirë në asnjë rast në marrëdhënien/t e qirasë;

iv) edhe në rast të moskonsiderimit të ligjshëm të shumës prej 5.745 USD, sërish subjekti rezulton me balancë pozitive në analizën financiare të periudhës 1996 – 2003.

- Në përfundim të hetimit administrativ, shuma prej 5.745 USD u konsiderua si e ardhur e ligjshme që ka shërbyer si një pjesë e dhuratës nga gjyshja në vlerën 10.000 euro.

28. Analizë e burimeve të tjera

28.1. Sa i takon burimit të ardhura nga pagat, viti 1996 – nëntor 2003, një pjesë e të cilave kanë qenë depozita në BKT, Alpha Bank e bono pranë Bankës së Shqipërisë, si dhe kursime nga pagat viti 2004 e 2005, u vërtetua se:

- Referuar dokumenteve të administruara²², të ardhurat nga pagat për periudhën 1996 – 2003, janë në vlerën 2.284.106 lekë për subjektin dhe 1.825.234 për bashkëshorten e tij. Kursimet nga pagat për vitet 2004 dhe 2005 kanë qenë respektivisht 117.061 lekë dhe 1.925 lekë deri në datën e likuidimit të kështit të fundit të apartamentit (6.5.2005).

- Nga verifikimi i të dhënave bankare rezulton se: (i) BKT-ja²³ nuk ka konfirmuar llogari depozita, etj., në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij; (ii) OTP Bank informoi se²⁴ subjekti ka pasur llogari që në vitin 1999 në të cilën, sipas ekstrakteve bankare, janë investuar depozita me afat nga periudha 1999 – 2003 kur janë tërhequr fondet. Gjithashtu, znj. Z. Z. (Gj.), bashkëshortja e subjektit, ka pasur llogari pranë kësaj banke që prej vitit 2000, në të cilën janë

²¹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.5.2018 të DPT-së.

²² Shihni vërtetimet e pagave të depozituara në aneksin *** dhe *** të dosjes ILDKPKI.

²³ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.6.2021 të BKT-së, në dosjen e Komisionit.

²⁴ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.4.2023 të OTP Bank, në dosjen e Komisionit.

depozituar dhe vendosur depozita me afat njëmuor; (iii) Banka e Shqipërisë²⁵ informoi se z. Enklid Gjini ka hapur llogari *cash*/titujsh për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar, me vlerë nominale 600.000 lekë në ankandin e zhvilluar në datën 8.7.2003, me maturim 1-vjeçar. Këtë investim subjekti e ka deklaruar edhe në deklaratën e vitit 2003, si një prej burimeve të deklaruara për blerjen e apartamentit.

28.2. Në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se:

i) Prindërit e bashkëshortes i kanë dhuruar asaj shumë prej 500.000 lekësh me rastin e lindjes së djalit në janar 2002, duke qenë se nga nëntori 1996 e deri në atë periudhë ai dhe bashkëshortja e tij kishin jetuar me ta. Edhe në deklaratën e vitit 2003 si OPGJ subjekti ka deklaruar 0.5 milion lekë dhuratë nga të afërmit. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti paraqiti dokumente mbi punësimin dhe të ardhurat e prindërve të bashkëshortes së tij nga paga dhe pensionet. Në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat e tyre për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

ii) Për pagesën e këstit në nëntor 2003, bashkëshortja Z. Gj. ka marrë 500.000 lekë në formën e borxhit motrës së saj V. Z., shumë e kthyer në shkurt 2004 kur ka tërhequr edhe bonon e thesarit. Në deklaratën e vitit 2003 si OPGJ subjekti ka deklaruar se shuma e tërhequr e bonove të thesarit (të cilat i ka deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*) ka shërbyer për borxhet e marra nga të afërmit për të paguar këstin e apartamentit në shumë 27.000 euro. Banka e Shqipërisë²⁶ ka konfirmuar se subjekti ka shitur bonot e thesarit para datës së maturimit, në datën 26.2.2004, periudhë që përputhet me deklaratën e subjektit në lidhje me burimin e kthimit të huas, marrë nga motra e bashkëshortes. Për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësës subjekti ka paraqitur vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nga ISSH nr. *** prot., datë 19.1.2021, për punësimin e saj gjatë periudhës 1998 – 2006. Të ardhurat për të cilat janë paguar detyrimet tatimore janë përfshirë në analizën financiare.

28.3. Në përfundim të hetimit administrativ nga analiza e të dhënave financiare, është vërtetuar se, prindërit e bashkëshortes dhe motra e saj kanë pasur mundësi financiare përkatësisht për të dhuruar shumë prej 500.000 lekësh dhe dhënë huan prej 500.000 lekësh. Në këto kushte këto shuma janë përfshirë si të ardhura të ligjshme për kryerjen e pagesave për blerjen e pasurisë objekt verifikimi në vitin 2003. Ndërsa shuma 500.000 lekë që i është kthyer motrës në shkurt të vitit 2004, është konsideruar si shpenzim i këtij viti.

29. Bazuar në sa më sipër, është kryer analiza financiare e përmbledhur si në tabelën më poshtë për pagesën e kësteve të apartamentit sipas vlerave përkatëse dhe në datat e cilësuar në deklaratën *Vetting*, të cilat përputhen me datat e mandatpagesave të administruara nga ILDKPKI-ja, nga ku rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të kryer pagesën e kësteve për blerjen e apartamentit.

Përshkrimi	1996 – 2003	Deri më 1.3.2004	Deri më 3.11.2004	1.1.2005 – 6.5.2005
Pasuritë	4 334 743	-209 442	707 020	617 291
Apartament banimi 88.5 m ² rruga “***”, Tiranë	3 716 360	393 450	569 520	688 380
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	<i>618 383</i>	<i>-602 892</i>	<i>137 500</i>	<i>-71 089</i>
Gjendja e likuiditeteve në banka	618 383	15 491	152 991	466 524
Të ardhurat	6 631 869	458 876	1 207 995	728 773
Të ardhura nga paga subjekti	2 284 106	159 009	424 024	267 076
Të ardhura nga paga bashkëshortja (tetor 2000 – tetor 2003)	1 825 234	294 054	686 126	461 697
Të ardhura nga int. bankare/BTH	148 929	5813		

²⁵ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.6.2021 të Bankës së Shqipërisë, në dosjen e Komisionit.

²⁶ Shihni shkresën kthim përgjigjeje të Bankës së Shqipërisë nr. *** prot., datë 29.3.2023, në dosjen e Komisionit.

Të ardhura dhuratë nga gjyshja (shitje pasurisë/të ardhura qiraja Ambasada Franceze)	1 373 600			
Të ardhura dhuratë nga prindërit e bashkëshortes (<i>Vetting</i>)	500 000			
Të ardhura dhënë borxh nga motra e bashkëshortes	500 000			
Të ardhura të mbartura deri në mars nga periudha të mëparshme			97 845	
Shpenzimet	1 690 591	570 473	419 613	109 557
Shpenzime jetike	1 690 591	70 473	187 928	109 557
Shpenzime mobilimi ap. 88.5 m ² , Tiranë			200 000	
Kthyer huaja motrës së bashkëshortes		500 000		
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS			31 685	
Mundësia për kursime	606 535	97 845	81 362	1 925

30. Pasuria apartament 1+1, sip. 53.5 m², Njësia Administrative Nr. ***, rruga “***”, ndërtesa ***, hyrja ***, ap. ***. Çmim blerjeje 1.900.000 lekë – burimi kredi në NBG 20.000 euro, datë 6.12.2007, objekt “Blerje/rikonstruksion banese. Rregullime sistemime shuma 1.200.000 lekë e paguar datë 28.2.2008 = 870.000 lekë dhe datë 2.8.2008 = 330.000 lekë – burim tërheqje depozitash 666.297 lekë + 4.340 euro në ISP Bank datë 21.1.2008”. Regjistruar ZVRPP Tiranë datë 4.12.2007 sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2007, ngarkuar me barrë hipotekore në favor të NBG-së deri në mbylljen e kredisë. Vlera: 3.100.000 lekë. Pjesa takuese 50%, regjistruar në emër të shtetasve Enklid dhe Z. Gj. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.

31. Në lidhje me përfitimin e pasurisë dhe statusin e saj nga aktet në dosje²⁷, rezultoi se:

- Sipas regjistrimit hipotekor nr. ***, datë 21.2.2005, figuron e regjistruar në emër të shtetasit K. D., pasuria apartament nr. ***, me sip. 53.5 m², me nr. pasurie ***, rruga “***”, Tiranë.

- Nga Komisioni u verifikua origjina e kësaj prone dhe u konstatua se: (i) sipas regjistrimit hipotekor nr. ***, datë 26.1.2005, figuron e regjistruar në pronësi të shtetasit K. D. pasuria nr. ***, truall me sipërfaqe 719 m², në rrugën “***”, Tiranë; (ii) sipas regjistrimit hipotekor nr. ***, datë 16.2.2005, figuron e regjistruar në pronësi të shoqërisë “***” sh.p.k., pasuria me nr. ***, objekt 6 dhe 8 kate me një kat parkim nëntokë në bllokun “***”; (iii) me kontratë shkëmbimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.2.2005, të lidhur mes shoqërisë “***” sh.p.k., në cilësinë e pronarit të pallatit, dhe shtetasit K. D. në cilësinë e pronarit të truallit, është bërë kalimi i ndërsjellë i pronësisë së garazheve dhe apartamenteve të ndërtuara nga shoqëria “***” sh.p.k. mbi sipërfaqen e truallit prej 719 m² në pronësi të shtetasit K. D., ndër të cilët edhe apartamenti 1+1, me nr. *** me sip. 53.5 m² + 5 m² ambient i përbashkët.

- Me kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2007, shtetasit Z. Gj. e Enklid Gjini kanë blerë nga shtetasit K. D. e A. D. apartamentin, nr. pasurie ***. Blerja e këtij apartamenti është deklaruar në DPV-në e vitit 2007.

- ASHK Tirana Jug²⁸ konfirmoi se kjo pasuri është regjistruar në emër të J. Gj. (djali i subjektit) në datën 26.5.2021 me kontratën e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.5.2021. FSHU-ja²⁹ nuk ka konfirmuar kontratë të furnizimit me energji elektrike në emër të subjektit Enklid Gjini apo bashkëshortes së tij në instancën Tiranë. Ndërkohë subjekti ka informuar se ende nuk është bërë ndryshimi i emrit të titullarit të saj, duke paraqitur kopjen e librezës së furnizimit

²⁷ Aktet në aneksin *** dhe *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe shihni aktet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.5.2023 nga ASHK Tirana Jug.

²⁸ Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.7.2021 nga ASHK Tirana Jug, në dosjen e Komisionit.

²⁹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.6.2021 nga FSHU-ja, në dosjen e Komisionit.

me energji me nr. *** në emër të shtetasit K. D. me adresën rruga “****”. UKT-ja³⁰ konfirmoi në emër të subjektit Enklid Gjini kontratën e furnizimit me ujë nr. *** dhe ka paraqitur kontratën e shitjes së kësaj pasurie.

32. Sa i takon çmimit të blerjes së pasurisë, u konstatua se:

- Në kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2007 parashikohet në vlerën 1.900.000 lekë, likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Në DPV-në e vitit 2007 dhe atë *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim kredie NBG 20.000 euro.

- ABI Bank³¹ konfirmoi transferimin në datën 7.12.2007 (pra 15 ditë pas lidhjes së kontratës së shitjes) të shumës 20.000 euro, përfituar me kredi, nga llogaria e subjektit në llogarinë nr. *** të shtetasit K. D., me përshkrimin “Blerje apartamenti nga Enklid Gjini sipas kontratës së shitblerjes” si dhe vuri në dispozicion praktikën e plotë të kredisë.

- I pyetur gjatë procesit në lidhje me likuidimin e çmimit të shitjes, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti informoi se në momentin e përpilimit të kontratës së shitjes nuk është bërë asnjë pagesë. Më tej ai ka sqaruar se kontrata e shitblerjes e datës 21.11.2007 është lidhur me qëllimin e vetëm për kalimin e pronës në emrin e tyre dhe hipotekimin e saj si garanci për bankën, ndërkohë që nuk i është kushtuar rëndësi çmimit të shitjes të shënuar në kontratë. Sipas tij, çmimi është likuiduar tek shitësit me transfertë bankare në datën 7.12.2007, sapo kredia u disbursua nga banka, dhe se, kjo pasuri është vendosur kolateral për të përfituar kredinë në shumën 20.000 euro. Subjekti ka paraqitur aktin bankar “transaksion i kalimit nga llogaria rrjedhëse të shitësi K. D. datë 7.12.2007”, në shumën 20.000 euro me përshkrimin “Pagesë për blerje apartamenti”.

- Veç sa më sipër, nga dokumentet bankare u konstatua se me deklaratën (pa akt noterial) e datës 25.10.2007 redaktuar para Bankës Kombëtare të Greqisë, shitësit K. dhe A. D. deklarojnë se i shesin blerësve Enklid Gjini dhe Z. Gj. apartamentin me adresë në rrugën “****”, ap. *** me sip. 53.5 m² në shumën 30.000 euro. Ata deklarojnë gjithashtu se shtetasit Enklid Gjini dhe Z. Gj. u kanë likuiduar shumën prej 10.000 euro dhe diferencën prej 20.000 euro do t’ua shlyejnë përmes kredisë pranë Bankës Kombëtare të Greqisë, deklarime të pranuar edhe nga blerësit Enklid Gjini dhe Z. Gj.

32.1. Nga sa më sipër, u vunë re të dhëna kontradiktore në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit. Me qëllim sqarimin e këtyre kontradiktave, u pyet subjekti mbi çmimin real të blerjes së pasurisë, mospërputhjet mes deklarimeve të tij dhe akteve shkresore, si dhe arsyet e blerjes më lirë të këtij apartamenti në vitin 2007, krahasuar me apartamentin e blerë në vitin 2005, të ndodhur në po të njëjtën godinë. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, në lidhje me çmimin e blerjes, sqaroi se në deklaratën *Vetting* ka deklaruar vlerën totale të pasurisë të përbërë nga: (i) 1.900.000 lekë (parashikuar në kontratën e shitjes) me burim kredi; (ii) 1.200.000 lekë rikonstruksion banese me burim kursime. Sa i takon deklaratës me datë 25.10.2007, deklaroi se ajo është bërë pas dakordësimit me shitësin se vlera e shitblerjes së apartamentit pas rikonstruksionit do të ishte 30.000 euro. Në vijim sqaron *se pas verifikimit të gjendjes së apartamentit nga të dyja palët, rezultoi se vlera e rikonstruksionit ishte rreth 10.000 euro, pasi gjendja e këtij apartamenti ishte shumë e keqe, për shkak të lagështirës së madhe që kishte në faqen e aneksit, në faqen e dritares së sallonit, në të gjithë dhomën e gjumit, e në të gjithë tualetin, pra duhej të hapej në tullë dhe të bëhej lëvizje muresh (muri ndarës aneks me sallon dhe lëvizja e murit të tualetit) për shkak të eliminimit të lagështirës.* Më tej, subjekti ka sqaruar se *shitësi Kujtim Doçi nuk pranoi të kryente rikonstruksionin e apartamentit, pasi këtë pasuri e ka përfituar si pronar truall, nuk ka banuar asnjëherë në të, dhe për më tepër, nuk ka shpenzuar asnjë lek.* Në këto kushte, sipas tij, u ra dakord që shtetasi K. D. nga shitja do të

³⁰ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.6.2021 nga UKT-ja, në dosjen e Komisionit.

³¹ Shihni shkresë nr. *** prot., datë 27.3.2023, në dosjen e Komisionit.

përfitonte shumën 20.000 euro, ndërsa diferenca prej 10.000 euro do të përdorej nga subjekti për rikonstruksionin e apartamentit që do të kryente shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k. Subjekti vijon të sqarojë se pas dakordësimit me shtetasin K. D., është vënë në dijeni edhe banka e cila u propozoi që ky ndryshim të reflektohet në kontratën e kredisë. Subjekti i referohet kontratës së kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., që ka për objekt “Blerjen/rikonstruksionin e një apartamenti me vlerë 20.000 euro që do të financohet nga banka dhe pjesëmarrja e kredimarrësve në këtë investim do të jetë në shumën 10.000 euro”, deklaram i cili përputhet me parashikimin në kontratën e kredisë. Në konkluzion të sqarimeve të tij, subjekti ka deklaruar se në të gjitha deklaratat e pasurisë ka deklaruar në kohë reale gjithë gjendjen e pasurive. Po kështu, subjekti ka deklaruar se vlera e paguar për blerje dhe rikonstruksion të apartamentit objekt verifikimi është 560,74 euro për metër katror.

33. Sa i takon çmimit të referencës

33.1. Sipas udhëzimit nr. 2, datë 4.4.2007, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “k”, vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të apartamenteve për qytetin e Tiranës, është 97.000 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi, pra vlera e apartamentit është 5.189.500 lekë. Subjekti ka shpenzuar 3.646.100 leke/30.000 euro (në fazën e përfundimit të hetimit administrativ si vlerë e paguar nga subjekti është konsideruar 30.000 euro) + 1.200.000 lekë për rikonstruksionin në vitin 2008. Pra, në total 4.846.100 lekë. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me investimin e një vlere më të ulët se çmimet referencë duke paraqitur kontrata të ngjashme.

33.2. Në parashtrimet e tij, në funksion të kësaj kërkesë, subjekti solli në vëmendje disa rrethana e fakte si vijojnë: (i) marrëdhënia kontraktore në rastin konkret është e ndërtuar me një individ dhe jo kompani ndërtimore, e për rrjedhojë, çmimi i caktuar është sipas vullnetit të palës shitëse; (ii) çmimi i shitjes në vlerën 97.000 lekë/m², në total 5.189.500 lekë që Komisioni i referohet, është bazuar në vlerën mesatare të shitjes së banesave në tregun e lirë për qytetin e Tiranës, sipas udhëzimit nr. 2, datë 4.4.2007 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “k”, për vitin 2007”, ndërkohë që ky udhëzim nuk specifikon çmimin mesatar të shitjes në tregun e lirë sipas zonave. Sipas tij, zona ***, e referuar edhe nga Komisioni, në të cilën ndodhet apartamenti i banimit (rruga **** ose ****), ndodhet jashtë zonës së ***, në *** e ***, e cila asokohe ka qenë zonë në zhvillim dhe jo e preferuar për banim; (iii) referuar udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, çmimi i shitjes së apartamenteve në zonën *** prej 82.000 lekë/m² nuk e ka arritur vlerën prej 97.000 lekë/m² edhe pas 9 vitesh; (iv) sipas vlerës së rivlerësimit të apartamentit në datën 27.5.2021 prej 4.387.000 lekësh, rezulton se çmimi mesatar i tregut të lirë të shitjes së aplikuar nga ZVRPP-ja ka qenë rreth 82.000 lekë/m². Në konkluzion sipas subjektit, vlera reale e investimit (blerja e apartamentit dhe rikonstruksioni i tij) është 560.74 euro/m² (67.800 lekë/m²), duke konsideruar gjithashtu faktin se apartamenti është i gjithi me drejtim nga veriu si dhe në gjendje shumë të keqe në momentin e blerjes për shkak të lagështirës, për të cilën u krye edhe rikonstruksioni.

Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti depozitoi dy kontrata të ngjashme shitje apartamentesh nga shoqëria “****” sh.p.k.: (i) kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.7.2006 me palë blerëse F. J. Vlera e apartamentit me sip. 67.14 m² është në shumën 3.500.000 lekë; (ii) kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.5.2007, me palë blerëse S. S. Vlera e apartamentit me sip. 60 m² është në shumën 3.000.000 lekë.

33.3. Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve që subjekti ka paraqitur, në procesin e vendimmarrjes, Komisioni i vlerësoi të arsyeshme pretendimet e tij dhe krijoi bindjen se vlera totale e investuar për pasurinë objekt verifikimi nuk ngre dyshime për ndonjë situatë

favorizuese të subjektit për shkak të detyrës dhe jo vetëm, bazuar në faktet dhe rrethanat si vijojnë:

- Shitësit kanë qenë pronarë të truallit dhe përfitues të apartamentit objekt verifikimi në këmbim të truallit. Fakti që ky apartament nuk është përdorur më parë prej tyre dhe ka pasur probleme për të cilat subjekti ka vijuar me rikonstruksion të tij në vlerën prej 1.200.000 lekësh, tregon se shitësit kanë qenë në kushte të vullnetit të lirë për të shitur pasurinë, qoftë edhe në vlerë më të ulët se vlera e shitjes në tregun e lirë për qytetin e Tiranës. Për më tepër, zona e ***, në periudhën që zë fill kjo marrëdhënie, nga të dhëna të njohura publikisht, dihet që ka qenë një zonë jo aq e preferuar sa zona e ***, pasi ka qenë një zonë ende në zhvillim dhe pa urbanistikë të zhvilluar. Ndërsa, referuar hartës treguese të pasurisë, apartamenti i përfituar nga subjekti është i pozicionuar i gjithi me drejtim nga veriu, çka e bën këtë apartament më pak të preferuar.

- Subjekti nuk u gjend në kushtet e konfliktit të interesit me shitësit e pasurisë bazuar në të dhënat e marra nga Prokuroria e Rrethit Tiranë³² dhe Fier³³, ku nuk rezultuan çështje të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit me shtetasit K. dhe A. D.

- Sipas dy kontratave të shitjeve të apartamenteve në të njëjtën zonë, në të njëjtën periudhë dhe të shitura nga e njëjta kompani ndërtimi që ka ndërtuar edhe apartamentin objekt verifikimi, çmimet janë përkatësisht: (i) 3.500.000 lekë ose 52.129,87 lekë/m² për apartamentin me sip. 67.14 m², ndodhur në pallatin me nr. pasurie ***; (ii) 3.000.000 lekë ose 50.000 lekë/m² për apartamentin me sip. 60 m², ndodhur në të njëjtin pallat me apartamentin objekt verifikimi me nr. pasurie ***. Nga krahasimi i këtyre çmimeve me çmimin e apartamentit objekt verifikimi në vlerën prej 20.000 euro + rikonstruksionin prej 1.200.000 lekësh, në total 3.624.000 lekë ose 67.738.31 lekë/m², rezulton se çmimi i paguar nga subjekti është më i lartë se çmimi i paguar nga dy blerësit e tjerë. Ndërsa në rastin që çmimi i blerjes do të konsiderohej 30.000 euro + rikonstruksionin prej 1.200.000, shuma e shpenzuar nga subjekti do të ishte edhe më e lartë, 90.581,30 lekë/m².

- Veç sa më sipër, edhe duke bërë krahasimin me apartamentin e blerë nga subjekti në të njëjtin pallat në vlerën 40.000 euro në vitin 2002 (pasuria e përshkruar në paragrafin 21) me sipërfaqe 96.5 m², çmimi për metër katror i të cilit është 415 euro, shpenzimi për apartamentin objekt verifikimi blerë në vitin 2007, është më i lartë, konkretisht 561 euro për metër katror.

34. Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e pasurisë

34.1. Subjekti ka deklaruar një kredi të marrë në NBG në shumën 20.000 euro datë 6.12.2007. Kjo kredi është deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2007 me qëllim për blerjen e apartamentit. Nga dokumentet e administruara konstatohet se me kontratë kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.12.2007, me palë kredidhënëse Banka Kombëtare e Greqisë, shtetasit Enklid Gjini e Z. Gj. kanë marrë një kredi në shumën 20.000 euro, me qëllim blerjen/rikonstruktimit e një apartamenti në Tiranë. Afati i shlyerjes 10 vjet. Kredia është deklaruar deri në DPV-në e vitit 2017 kur dhe ka përfunduar likuidimi total i saj. Nga dokumentet e ABI Bank³⁴ vërtetohet transferimi i shumës 20.000 euro nga llogaria e subjektit në llogarinë nr. *** të shtetasit K. D. me përshkrimin “Blerje apartamenti nga Enklid Gjini sipas kontratës së shitblerjes” në datën 7.12.2007. Siç vërehet, shuma 20.000 euro i është paguar shitësit pas disbursimit të kredisë, pra, 16 ditë pas lidhjes së kontratës së shitjes me datë 21.11.2007. Gjatë procesit të rivlerësimit subjekti e pranoi këtë fakt duke sqaruar se kontrata është redaktuar më parë me qëllimin e

³² Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.4.2023 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

³³ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 31.3.2023 nga Prokuroria e Rrethit Fier, në dosjen e Komisionit.

³⁴ Shihni shkresën kthim përgjigjeje të Bankës Amerikane të Investimeve nr. ***, datë 27.3.2023, në dosjen e Komisionit (ABI Bank ka blerë Bankën Kombëtare të Greqisë) dhe dokumentacionin bashkëngjitur shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.5.2023 nga ABI Bank, në dosjen e Komisionit.

vetëm të regjistrimit të pasurisë në emër të tij dhe bashkëshortes dhe vënien e saj si garanci për lëvrimin e kredisë, si dhe, thekson faktin se është vërtetuar që kredia është përdorur për blerjen e pasurisë.

34.2. Në përfundim të hetimit administrativ, nisur nga praktika bankare që për arsye praktikiteti dhe përshpejtim procedurash, palët kanë operuar duke dakordësuar transferimin e titullit të pronësisë përpara disbursimit të kredisë si dhe fakti që vetëm 16 ditë pas redaktimit të kontratës së shitjes shuma e përfituar me kredi prej 20.000 euro ka kaluar direkt në llogarinë bankare të palës shitëse me përshkrim të mirëpërcaktuar, kredia prej 20.000 euro është konsideruar si burim për blerjen e apartamentit.

35. Në lidhje me rikonstrukcionin e apartamentit, rezultoi se:

- Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “*Rregullime sistemime shuma 1.200.000 lekë e paguar datë 28.2.2008 = 870.000 lekë dhe datë 2.8.2008 = 330.000 lekë – burim tërheqje depozitash 666.297 lekë + 4.340 euro në ISP Bank datë 21.1.2008*”.

- Në DPV-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar: “*Mbyllje depozite me afat 3-mujor në datën 10.1.2008, në Bankën Amerikane dhe kaluar për shlyerjen e detyrimit shoqërisë “****” sh.p.k. për përfundimin e punimeve në datën 28.2.2008 të apartamentit të banimit me sip. 53.5 m², në godinën 6 dhe 8 kate në rrugën “****”, Tiranë*”.

- Sa i takon mënyrës së likuidimit të këtyre shumave shoqërisë “****” sh.p.k. subjekti ka paraqitur: (i) mandatarkëtimin nr. ***, datë 28.2.2008, për shumën 870.000 lekë, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., paguar nga z. Enklid Gjini, *likuidim pjesor për rikonstrukcion apartamenti 1+1. Mbetur edhe 330.000 lekë*; (ii) mandatarkëtimin nr. ***, datë 2.8.2008, për shumën 330.000 lekë nga shoqëria “****” sh.p.k., paguar nga z. Enklid Gjini, *për likuidim total për rikonstrukcion apartamenti 1+1*. I pyetur gjatë procesit mbi ndonjë akt apo marrëveshje mes tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k., subjekti ka informuar³⁵ se mes tyre ka pasur vetëm marrëveshje verbale dhe se pagesat për këto punime janë kryer sipas mandatarkëtimeve të mësipërme të paraqitura edhe më parë. Më tej subjekti ka informuar mbi llojin e punimeve të kryera, si lëvizje të mureve ndarës, risuvatime, shtrime pllakash, instalime elektrike dhe hidraulike etj.

- Në lidhje me periudhën e rikonstrukcionit dhe gjendjen e apartamentit në momentin e dhënies me qira subjekti ka deklaruar³⁶ se rikonstrukcioni nisi pas kalimit të kredisë në llogari të shitësit K. D. dhe marrjes së çelësave dhe në fund të janarit u përfunduan të gjitha punimet e kryera nga shoqëria. Në shkurt të vitit 2008 ishte gati për t’u dhënë me qira. Sa i takon mobilimit të apartamentit në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se nuk janë kryer shpenzime mobilimi, pasi ai është dhënë me qira bosh. Nëpërmjet kontratave të qirasë u vërtetua dhënia me qira e apartamentit sipas deklarimeve të subjektit.

Në përfundim të hetimit administrativ u konstatua se subjekti ka qenë i saktë në deklarime dhe shuma e rikonstrukcionit prej 1.200.000 lekësh u konsiderua si shpenzim për vitin 2008.

36. Në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për rikonstrukcionin e apartamentit, rezultoi se:

36.1. Në deklaratën *Vetting* është deklaruar si burim tërheqje depozitash 666.297 lekë dhe 4.340 euro në ISP Bank në datën 21.1.2008. Në DPV-në e vitit 2008 është deklaruar: “*Mbyllje depozite me afat tremujor në datën 10.1.2008 në Bankën Amerikane dhe kaluar për shlyerjen e detyrimit firmës “****” për përfundimet e punimeve në (datë 28.2.2008)...*”. Subjekti ka paraqitur dokumentet si vijojnë: (i) kontratë depozite datë 8.1.2007 në emër të shtetasve Z. e Enklid Gjini pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, vlerë 4.250 euro, afat maturimi 3 muaj;

³⁵ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

³⁶ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3, në dosjen e Komisionit.

(ii) kontratë depozite datë 8.1.2007 në emër të shtetasve Z. e Enklid Gjini pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, vlerë 650.000 lekë, afat maturimi 3 muaj; (iii) mandat tërheqje *cash* datë 21.1.2008 në Bankën Amerikane të Shqipërisë nga z. Enklid Gjini të shumave 4.383,31 euro dhe 672.797 lekë, në total 1.207.383 lekë.

36.2. Nga ana e Komisionit u verifikuan deklaratimet e likuiditeteve *cash* me qëllim evidentimin e mundësisë financiare për depozitat e sipërpërmendura, nga ku rezulton se:

- Në DPV-në e vitit 2005 dhe DPV-në e vitit 2006 subjekti ka deklaruar përkatësisht gjendje *cash* në vlerën 500.000 lekë, pra në fund të vitit 2006 vlera *cash* e raportuar është 1.000.000 lekë.

- Në DPV-në e vitit 2007 subjekti ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* me 1.375.000 lekë dhe vendosje të tyre në depozita me afat pranë Bankës Amerikane (sot ISP Bank) më 8.1.2007 përkatësisht: 650.000 lekë dhe 4.250 euro. Sikurse vërehet, ka një pasaktësi në deklarin e gjendjes *cash* të pakësuar, pasi gjendja *cash* në fund të vitit është 1.000.000 lekë.

- Nga dokumentacioni i administruar nga ISP Bank³⁷ vihet re që në datën 8.1.2007 janë kryer nga bashkëshortja e subjektit dy depozitime *cash* prej 387.000 lekësh dhe 4.250 euro në llogarinë e bankës “***” ***. Pra, në total janë depozituar 914.680³⁸ lekë. Gjithashtu, në këtë llogari në datën 8.1.2007 është transferuar vlera prej 263.000 lekësh nga llogaria e pagës së bashkëshortes së subjektit, shumë e cila së bashku me shumën 387.000 lekë, përbëjnë vlerën 650.000 lekë, depozituar më 8.1.2007 në Bankën Amerikane.

36.3. Nga Komisioni është verifikuar mundësia e krijimit të gjendjes *cash* në vitet 2005 dhe 2006, paraqitur si në tabelën më poshtë, nga ku rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumat 500.000 lekë për secilin vit.

Përshkrimi	2005	2006
Pasuritë	881,968	887,873
Apartament me sip. 88.5 m ² , Tiranë	688,380	
Automjet tip “***” blerë shkurt 2006		250,000
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	<i>193,588</i>	<i>637,873</i>
Gjendja e likuiditeteve	711,201	1,349,074
Të ardhurat	2,101,527	2,165,948
Të ardhura nga paga subjekti	777,741	836,519
Të ardhura nga paga bashkëshortja	1,318,990	1,329,429
Të ardhura nga interesa bankarë	4,796	0
Shpenzimet	630,950	753,630
Shpenzime jetese	328,671	328,671
Shpenzime mobilimi ap. 88.5 m ² , Tiranë (sipas pyetësorit standard)	300,000	100,000
Shpenzime për zhdoganimin e aut. “***”, blerë në vitin 2006		250,437
Shpenzime komisione bankare	2,279	300
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS	0	74,222
Mundësia për kursime	588,609	524,445

37. Sa i takon shumës 10.000 euro, paguar në datën 25.10.2007, sipas deklaratës së datës 25.10.2007, pavarësisht deklaratimeve të subjektit, deri në fazën e përfundimit të hetimit administrativ Komisioni e konsideroi të paguar këtë shumë nga subjekti dhe kreu analizën financiare si në tabelën më poshtë, nga e cila duket se subjekti nuk ka justifikuar tërësisht me të ardhura të ligjshme këtë shumë për shkak të një balance negative prej 411.716 lekësh.

Përshkrimi	Deri më 25.10.2007
------------	--------------------

³⁷ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.4.2023 dhe dokumentacioni bashkëngjitur, të ISP Bank, në dosjen e Komisionit.

³⁸ Në përllogaritje është shuma 387.000 lekë dhe ekuivalenti i 4.250 euro = 527.680 (kursi zyrtar euro/lekë për datën 8.1.2007 i Bankës së Shqipërisë është 124.16).

Pasuritë	1,215,120
Apartament banimi 53.5 m ² Tiranë	1,222,100
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	-6,980
Gjendja e likuiditeteve në banka	1,342,094
Të ardhurat	1,404,664
Të ardhura nga paga subjekti	660,623
Të ardhura nga paga bashkëshortja	744,041
Shpenzimet	601 260
Shpenzime jetike	341,550
Shpenzime interes ovd bsh ISP	1,500
Shpenzime TIMS	258 210
Mundësia për kursime	-411,716

38. Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës, duket se:

- Ka mospërputhje në lidhje me çmimin e shitjes së pasurisë në kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2007 dhe deklaratën e datës 25.10.2007, të dyja akte të nënshkruara nga subjekti, i cili ka nënshkruar akte që përmbajnë fakte të pavërteta referuar deklarimeve të tij.

- Ka mungesë burimesh financiare për pagesën e shumës 10.000 euro në datën 25.10.2007 sipas deklaratës së kësaj date për shkak të një balance negative prej 411.716 lekësh.

- Është e paqartë pse është vënë si garanci për kredinë e marrë në NBG apartamenti objekt verifikimi, ndërkohë që subjekti zotëronte të regjistruar në pronësi të tij dhe bashkëshortes pasurinë nr. ***, apartamenti ku aktualisht jeton që prej shtatorit të vitit 2005.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

39. Sa i takon mospërputhjeve të çmimit të blerjes së pasurisë, në parashtrimet e tij subjekti ka dhënë përgjithësisht të njëjtat deklarime si në përgjigje të pyetësorit nr. 4, duke u fokusuar më së shumti te argumentimi i arsyeve që kanë çuar në hartimin e deklaratës pa akt noterial në datën 25.10.2007, për të cilën vijon të sqarojë se është redaktuar nga banka kredidhënëse për efekt të fillimit të procedurës për marrje kredie dhe pas një marrëveshjeje fillestare me shitësin e pasurisë që çmimi të ishte 30.000 euro. Më tej, subjekti vijon se pasi është verifikuar gjendja e apartamentit, pala shitëse nuk ka pranuar të shpenzojë 10.000 euro për rikonstruksionin e apartamentit, dhe se, ata ranë dakord që këto punime t'i kryente vetë subjekti, duke i paguar shitësit vetëm shumën 20.000 euro. Sipas subjektit, këto ndryshime iu bënë me dije edhe bankës, e cila i reflektoi në kontratën e kredisë me objekt "Blerjen/rikonstruksionin e një apartamenti me vlerë 20.000 euro që do të financohet nga banka dhe pjesëmarrja e kredimarrësve në këtë investim do të jetë në shumën 10.000 euro". Gjithashtu, në sqarimet e tij, subjekti i referohet edhe transferimit të shumës së disbursuar prej 20.000 euro në llogarinë e shitësit nëpërmjet veprimit bankar të datës 7.12.2007. Sipas tij, si në DPV-në e vitit 2007 ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, është deklaruar në kohë reale situata siç ka ndodhur realisht.

39.1. Për të mbështetur pretendimet e tij, në datën 5.7.2023, përpara zhvillimit të seancës dëgjimore, subjekti i përcolli Komisionit në rrugë elektronike një komunikim me *email* mes tij dhe shtetasit K. D. (shitësi i pasurisë). Në këtë *email* ky shtetas informon subjektin Enklid Gjini, se është në pamundësi të dhënies së një deklaratë noteriale për shkak se ndodhej në Suedi, duke i dërguar faqe të pasaportës së tij dhe bashkëshortes A. D., nga ku rezulton se ai ishte larguar nga Kosova më 12.6.2023. Gjithashtu ai i konfirmon subjektit dhe Komisionit përmes *email*-it, se për shitjen e apartamentit të subjektit 1+1, nr. ***, ngjitur me shtëpinë e tij, ai ka marrë pagesën prej 20.000 euro, përmes NBG-së.

40. Po kështu, subjekti kundërshton përfshirjen e shumës 10.000 euro si shpenzim i tij në datën 25.10.2007 dhe vijon të këmbëngulë se nuk ka kryer asnjë pagesë në muajin tetor 2007 duke

argumentuar se gjendja e likuiditeteve në datën 25.10.2007 ishte në total 805.489 lekë dhe 4.343,89 euro. Nëse do të ishte paguar shuma 10.000 euro (të cilat i kishte gjendje likuiditeti), nuk do të kishte asnjë arsye për të mos e deklaruar këtë pagesë, ashtu sikurse ka deklaruar detyrimin ndaj shoqërisë “***” sh.p.k. për rikonstruksionin e këtij apartamenti në vlerën prej 1.200.000 lekësh në kohë reale, në DPV-në e vitit 2007. Në vijim, duke theksuar se nuk ka pasur asnjë qëllim për mosdeklarimin apo fshehjen e shumës prej 10.000 euro (sipas deklaratës së bankës), ka kërkuar nga Komisioni të marrë në konsideratë faktet dhe deklaratat e paraqitura prej tij dhe bashkëshortes së tij në DPV-në e vitit 2007, deklaratën *Vetting* dhe gjithë shpjegimet e dhëna gjatë këtij procesi hetimor, duke mos e përfshirë shumën 10.000 euro si shpenzim të tij.

41. Ndërsa sa i takon faktit të vendosjes si garanci në NBG të pasurisë objekt verifikimi dhe jo të apartamentit tjetër të blerë më parë në çmimin 40.000 euro, subjekti sqaroi se që në momentin e parë është menduar që për blerjen e apartamentit objekt verifikimi me kredi të vihej garanci hipotekore ky apartament. Ky mendim ka ardhur natyrshëm edhe për efekt të vlerave të ndryshme të dy apartamenteve, pasi për kredinë 20.000 euro është e natyrshme të vihet garanci apartamenti pak a shumë me të njëjtën vlerë dhe jo apartamenti tjetër që kishte vlerë sa dyfishi i kredisë.

42. Pra, në mënyrë të përmbledhur, subjekti, ashtu sikurse dhe gjatë procesit, në parashtrimet e veta vijon të këmbëngulë se çmimi i paguar shitësit për pasurinë objekt verifikimi është 20.000 euro, paguar me kredinë e marrë në datën 7.12.2007, dhe se, vlera e pasurisë është ajo e deklaruar në deklaratën *Vetting*: 20.000 euro paguar me kredi + 10.000 euro/1.200.000 lekë, shpenzuar për investime rikonstruksioni paguar me kursime familjare.

Vlerësimi i Komisionit

43. Në analizë të argumenteve të subjektit dhe të gjitha fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ, në përfundim të procesit Komisioni vlerëson se:

- Është e vërtetë që në kontratën e shitjes së datës 21.11.2007 pasqyrohet çmimi i shitjes 1.900.000 lekë likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Por, u vërtetua që çmimi i përfituar nga pala shitëse është 20.000 euro dhe është paguar 16 ditë më vonë, në datën 7.12.2007, përmes një kredie bankare në NBG, e cila është transferuar në llogarinë bankare të shitësit K. D., me përshkrimin “Blerje apartamenti nga Enklid Gjini”, kredi e cila është deklaruar saktësisht me qëllim blerje apartamenti që në DPV-në e vitit 2007.

- Sa i takon redaktimit të kontratës së shitjes së datës 21.11.2007 pa u paguar realisht çmimi i blerjes së pasurisë, njihen raste nga praktika bankare që për arsye praktikiteti dhe përshpejtim procedurash, palët kanë operuar duke dakordësuar transferimin e titullit të pronësisë përpara disbursimit të kredisë, duke shmangur hartimin e një akti noterial me kusht kreditimi, apo vendosjen e shitësve (dhe nënshkrimin e akteve respektive) në cilësinë e hipotekuesit. Për më tepër, është në interes të klientit që të vendosë si garanci hipotekore pronën objekt financimi apo një pasuri me çmim të përafërt me çmimin e pasurisë objekt kredie, dhe jo detyrimisht pronën ku jeton. Një praktikë e tillë është ndjekur edhe në raste të tjera nga subjekte rivlerësimi, të cilët e kanë kaluar procesin e *Vetting*-ut me vendime të formës së prerë³⁹ (raste kur nuk janë evidentuar deklarime të rreme me qëllim fshehjen e fakteve e rrethanave nga subjektet e rivlerësimit). Këto rrethana si dhe disbursimi i kredisë vetëm 16 ditë pas redaktimit të aktit të shitjes, e bëjnë të besueshëm deklarimin e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, se kontrata e shitjes është lidhur me qëllim vënien si garanci të pasurisë objekt i saj deri në shlyerjen e kredisë, dhe se, nuk i ka kushtuar rëndësi çmimit 1.900.000 lekë në kontratën e shitjes.

³⁹ Shihni vendimin e Komisionit nr. ***, datë 7.6.2021 që i përket subjektit V. Ç.

- Më tej, deklarimi i çmimit të shitjes 1.900.000 lekë në deklaratën *Vetting*, vlerësohet se është bërë referuar pikërisht çmimit të përcaktuar në kontratë dhe jo me ndonjë qëllim të caktuar për pasqyrimin në mënyrë të pavërtetë të çmimit të blerjes. Këtë bindje e përforcon edhe fakti që në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e pasurisë kredinë prej 20.000 euro (e cila është vërtetuar se është përdorur për blerjen e pasurisë) plus investim për rikonstrukcion 1.200.000 lekë me burim kursime familjare, deklarime të cilat përputhen plotësisht me ato në DPV-të e viteve 2007 dhe 2008. Nga ana tjetër, bazuar në të gjitha faktet dhe provat e rezultuara gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk gjen asnjë qëllim përfitimi të subjektit nga vendosja e çmimit 1.900.000 lekë në aktin e shitjes.

43.1. Në përfundim, bazuar në sa është arsyetuar si më sipër, Komisioni çmon se mospërputhjet në vlerat e çmimit të shitjes së pasurisë dhe mënyrës së likuidimit të tij, nuk mund të penalizojnë subjektin, për arsye se nuk vërtetohet dhe as nuk ka dyshime për kryerjen e deklarimeve të rreme me qëllim fshehjen e ndonjë fakti e rrethane prej tij, sidomos në kushtet kur investimi total në pasuri u vërtetua të jetë kryer me burime të ligjshme.

44. Sa i takon shumës 10.000 euro referuar në deklaratën e datës 25.10.2007, në një analizë logjike ë fakteve të rezultuara në raport edhe me deklaratimet e subjektit, në përfundim të procesit, Komisioni krijoi bindjen se kjo shumë nuk është shpenzuar nga subjekti në këtë datë, dhe se deklarata është redaktuar për efekt të marrjes së kredisë prej 20.000 euro bazuar në marrëveshjen fillestare me shitësin e pasurisë. Kjo bindje përforcohet edhe nga faktet dhe provat si vijojnë:

i) Të dhënat në kontratën e kredisë me objekt blerjen/rikonstruktimin e një apartamenti në Tiranë ku pjesëmarrja e kredimarrësve në këtë investim është 10.000 euro, si dhe, disbursimi i shumës prej 20.000 euro në datën 7.12.2007, transferuar direkt në llogarinë e shitësit K. D., përputhen me të dhëna e deklaratës së datës 25.10.2007, sipas së cilës çmimi i shitjes së pasurisë do të ishte 30.000 euro, nga të cilat 20.000 euro do të paguhej me kredi bankare. I vetmi ndryshim është se shuma 10.000 euro, me marrëveshje të palëve, nuk i është paguar shitësit K. D. për të kryer rikonstrukcionin e apartamentit, por shoqërisë që ka kryer punimet e rikonstrukcionit.

ii) Deklarimi në kohë reale në DPV-në e vitit 2007 i detyrimit për investimin/rikonstrukcionin e apartamentit ndaj kompanisë në vlerën 1.2 milionë lekë, ekuivalenti i vlerës 10.000 euro sipas deklaratës së datës 25.10.2007 dhe deklarimi i shlyerjes së këtij detyrimi në DPV-në e vitit 2008 (me të ardhura të ligjshme), provon pjesëmarrjen e subjektit në investim me fondet e veta, por, pasi ishte paguar shuma 20.000 euro në vitin 2007 nëpërmjet kredisë, rrjedhimisht pas datës 25.10.2007 të redaktimit të deklaratës nga NBG Bank.

iii) Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit, në datën e nënshkrimit të deklaratës përpara bankës 25.10.2007, minimalisht subjekti ka pasur 1.3 milionë lekë, mjaftueshëm për të mbuluar shumën prej 10.000 euro, ndërkohë që depozitat që përbëjnë këtë shumë janë përdorur për rikonstrukcionin e apartamentit në vitin 2008.

iv) Deklarimi i shtetasit K. D. (përmes komunikimit elektronik) përforcon deklaratimet e subjektit se për blerjen e pasurisë atij i ka paguar vetëm 20.000 euro. Vlen të theksohet se ky deklaram nuk mund të anashkalohej si i paraqitur gjatë procesit (në parashtrime), pasi u vërtetua se ky shtetas nuk ka qenë në Shqipëri në periudhën kur subjekti është njohur me konstatimet e Komisionit, në datën 15.6.2023. Referuar faqes së pasaportës të përcjellë prej subjektit, e cila mban vulën e aeroportit ***, Kosovë, shtetasi K. D. duket të jetë larguar nga Kosova në datën 12.6.2023. Nga ana tjetër, kjo deklaratë paraqitur nga subjekti sipas së drejtës që i jep neni 47 i Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon mundësinë e subjekteve që në çdo fazë të procedurës të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet si dhe të depozitojnë prova, është në koherencë të plotë me faktet dhe provat e administruara si dhe, me deklaratimet e subjektit si në DPV ashtu edhe gjatë procesit.

44.1. Bazuar në sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se vlera në total e shpenzuar për pasurinë objekt verifikimi është 30.000 euro, aq sa është përcaktuar çmimi në deklaratën e datës 25.10.2007 përpluar pranë NBG Bank. Nga kjo shumë, 20.000 euro janë paguar me kredi bankare në vitin 2007 dhe 10.000 euro/1.200.000 lekë janë paguar nga subjekti në vitin 2008 për shpenzimet e rikonstruksionit me kursime familjare të krijuara me të ardhura të ligjshme, të cilat janë deklaruar saktësisht dhe në kohë reale, sikurse subjekti pretendon. Konkretisht: (i) në DPV-në e vitit 2007 është deklaruar marrja e kredisë për blerje apartamenti dhe detyrimi prej 1.200.000 lekësh ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. për rikonstruksionin e tij në vlerën prej 1.200.000 lekësh, me afat përfundim punimesh brenda tre muajve; (ii) në DPV-në e vitit 2008 shuma 1.200.000 lekë është deklaruar si shpenzim me qëllim shlyerje detyrimi, ndërkohë që në këtë deklaratë dhe në vijim subjekti ka deklaruar saktësisht detyrimet financiare për shkak të kredisë; (iii) në deklaratën *Vetting* janë deklaruar saktësisht kredia dhe investimet për rikonstruksionin.

44.2. Në përfundim, Komisioni nuk gjen shkak për penalizim të subjektit për shkak të redaktimit të deklaratës së datës 25.10.2007. Por, edhe nëse shuma 10.000 euro do të konsiderohej e paguar nga subjekti në këtë datë (mbi shumën 30.000 euro shpenzuar realisht për blerjen dhe investimin në pasuri), balanca negative prej 411.716 lekësh nuk është e atij niveli që të penalizojë subjektin e rivlerësimit.

44.3. Sa i takon faktit të vendosjes si garanci pranë NBG Bank të pasurisë objekt shqyrtimi, ashtu sikurse u arsyetua më sipër, sqarimi i subjektit vlerësohet i arsyeshëm dhe bindës për Komisionin. Është në interesin e kreditorit dhe debitorit që të vendosë si kolateral një pasuri me çmim të përafërt me çmimin e pasurisë objekt kredie. Gjithashtu është në interes të klientit që të vendosë si garanci hipotekore pronën objekt financimi dhe jo detyrimisht pronën ku jeton. Përveç kësaj, është në zgjedhjen e klientit përzgjedhja e pasurisë që do të vihet si garanci për shlyerjen e kredisë.

45. Pasuria *garazh me sip. 22.75 m², Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, ndërtesa ***, hyrja ***, garazh nr. ***. Paguar datë 13.3.2008 – burimi kursime nga paga. Regjistruar në ZVRPP Tiranë në datën 11.4.2008 sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.3.2008. Vlera: 3.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Regjistruar në emër të Enklid Gjini. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.*

46. Në lidhje me përfitimin e pasurisë nga aktet në dosje⁴⁰, rezultoi se:

- Sipas regjistrimit nr. ***, datë 16.2.2005 figuron e regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. pasuria me nr. ***, garazh me sip. 22.75 m².

- Me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.3.2008, z. Enklid Gjini ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. garazhin nr. ***, me nr. pasurie ***, me sip. 22.75 m², në çmimin 3.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale, vërtetuar me mandatarkëtimin nr. *** datë 13.3.2008. Sipas regjistrimit nr. *** datë 9.4.2008 pasuria figuron e regjistruar në emër të shtetasve Enklid Gjini e Z. Gj.

- Në DPV-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar pasurinë por pa deklaruar burimin e krijimit. Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi se mospasqyrimi i burimit të krijimit të pasurisë në DPV-në e vitit 2008, ka qenë thjesht një harresë. Sipas tij, duke pasur parasysh që janë deklaruar saktë të gjitha të ardhurat e tyre nga punësimi, është e kuptueshme që si burim kanë shërbyer këto të ardhura (të cilat janë depozituar në sistemin bankar). Nga ana e Komisionit, mosdeklarimi i burimit të krijimit në DPV-në e vitit 2008, vlerësohet si një pasaktësi formale, pasi nuk shoqërohet me pamundësi financiare.

⁴⁰ Shihni aktet në aneksin *** dhe ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

- Sipas kartelës së pasurisë paraqitur nga ASHK Tirana Jug⁴¹, kjo pasuri është e regjistruar 100% në pronësi të shtetases Z. Gj., pas heqjes dorë nga pronësia e ½ të pjesë takuese nga ana e subjektit Enklid Gjini, sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.6.2021.

47. Bazuar në Udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, çmimi për 1 m² sipërfaqe garazh është 70% e çmimit të sipërfaqeve së apartamenteve të banimit sipas zonave. Çmimet minimale të shitjes për efekt fiskal (lekë/m²) viti 2008, për qytetin e Tiranës, zona ***⁴², ku ndodhet garazhi, është 82.500 lekë/m². Në rastin konkret çmimi i referencës për garazh rezulton 82.500 lekë/m² x 0.7 = 57.750 lekë/m² ose në total 57.750 lekë x 22.75 m² = 1.313.812,5 lekë (10.665.79 euro, sipas kursit të vitit 2008), pra rezulton se garazhi është blerë më lirë se çmimi minimal fiskal. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim, si dhe të paraqesë kontrata të ngjashme.

47.1. Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi se garazhi është blerë me vlerën e deklaruar dhe jo me vlerën sipas EKB-së, duke iu referuar kryesisht problematikës së zonës për sa i përket përmbajtjeve, që sipas tij, vijon edhe sot me gjithë ndërhyrjet për sistemim të rrugës nga ana e Bashkisë pas vitit 2010. Në mbështetje të sqarimeve të tij, subjekti ka depozituar: (i) kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.6.2007, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse P. e K. O. Vlera e garazhit me sip. 28 m² është 2.800 euro; (ii) kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.6.2007, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse B. S.. Vlera e garazhit me sip. 37 m² është 3.000 euro. Të dyja këto garazhe ndodhen në një objekt në të njëjtën zonë kadastrale dhe afër me pasurinë objekt verifikimi, të ndërtuar nga e njëjta shoqëri ndërtimi. Nga krahasimi i çmimeve vihet re se subjekti e ka blerë pasurinë objekt verifikimi pothuajse njësoj me blerësit e tjerë. Në këto rrethana si dhe në kushtet kur nuk u vërtetua që ai të jetë në gjendjen e një konflikti interesi me shoqërinë dhe administratorin e saj⁴³, në përfundim të hetimit administrativ nuk ka pasur dyshime për favorizim të subjektit të rivlerësimit.

48. Në lidhje me burimin e krijimit me kursime nga paga, është kryer analiza financiare si në tabelën më poshtë, bazuar në të ardhurat nga pagat dhe shpenzimet deri në blerjen e pasurisë⁴⁴. Në këtë analizë nuk është përfshirë e ardhura nga qiraja e apartamentit 53.5 m², Tiranë (trajtuar tek konstatime të tjera).

Përshkrimi	13.3.2008
PASURI	- 274 705
Garazh me sip. 22.75 m ²	649 555
Shtesa/pakësime likuiditeteve	-603 994
Gjendja e likuiditeteve	983 807
TË ARDHURA	426 942
Të ardhura nga paga subjekti	163 799
Të ardhura nga paga bashkëshortja + leje barrë lindjeje	223 925
Të ardhura nga interesa bankarë	39 218
SHPENZIME	1 062 812
Shpenzime jetese (4 persona)	113 850
Shpenzime pagese kredie NBG Bank (princ + int)	78 662
Shpenzime për rikonstruksionin e apartamentit 53.5 m ² dhënë në datën 28.2.2008 (pagesa e parë)	870 000
Shpenzime komisione bankare	300
Shpenzime udhëtimi TIMS	0

⁴¹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.7.2021 nga ASHK Tirana Jug, në dosjen e Komisionit.

⁴² Shihni udhëzimin nr. 1, datë 20.8.2008, të publikuar në faqen zyrtare të EKB-së https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/udhzim_1_20.08_2.pdf

⁴³ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.4.2023 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 31.3.2023 nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, në dosjen e Komisionit.

⁴⁴ Shihni kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol. datë 13.3.2008.

49. Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës, duket se subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm mundësi financiare për blerjen e pasurisë garazh dhe mbuluar shpenzimet e tjera, për shkak të një balance negative në vlerën 361.165 lekë. Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë në DPV-në e vitit 2008.

50. Në parashtrimet e tij, subjekti sqaron se në datën 21.1.2008 bashkëshortja ka tërhequr nga ISP Bank depozitat, në shumat 673.582 lekë dhe 4.387 euro, shuma këto të përdorura: (i) me mandatarkëtimin nr. *** datë 28.2.2008 janë paguar pranë shoqërisë “****” sh.p.k. shuma 870.000 lekë “likuidim pjesor për rikonstruksion apartamenti 1+1”; (ii) me mandatarkëtimin nr. *** datë 13.3.2008 janë paguar pranë shoqërisë “****” sh.p.k. shuma 3.000 euro “likuidim total garazhi”. Sipas tij, në analizën e bërë nga Komisioni për datën 13.3.2008 është llogaritur si gjendje *cash* shuma 337.383 lekë. Ndërkohë, pas tërheqjes nga Intesa Sanpaolo Bank, shumat 673.582 lekë dhe 4.387 euro janë përdorur për sa më sipër. Duke qenë se pagesat e bëra për rikonstruksionin e apartamentit në shumën 1.200.000 lekë dhe për blerjen e garazhit në shumën 3.000 euro i janë dhënë të njëjtit person, shtetasit A. L., në deklaratën *Vetting* është deklaruar si burim për rikonstruksionin e apartamentit tërheqja e depozitave 666.297 lekë dhe 4.340 euro dhe për pagesën e garazhit kursime nga paga pasi në total këto kanë qenë burimet reale të pagesave të kryera. Për pagesën e datës 2.8.2008 të kryer me mandatarkëtimin nr. *** “likuidimin total për rikonstruksion apartamenti 1+1” në shumën 330.000 lekë kanë shërbyer si burim kursimet nga pagat deri në datën 2.8.2008. Subjekti ka paraqitur analizën financiare duke u mbështetur në analizën e Komisionit vetëm duke korrigjuar shumën e lënë si gjendje *cash* në datën 13.3.2008 nga ku rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e garazhit.

51. Në analizë të sqarimeve të subjektit, Komisioni e vlerësoi të logjikshëm arsyetimin e tij se shuma prej 337.383 lekësh gjendje *cash* e mbetur pas tërheqjes së depozitave prej 673.582 lekësh dhe 4.387 euro në datën 21.1.2008, si dhe pagesës së këstit të parë të rikonstruksionit të apartamentit prej 870.000 lekësh në datën 28.2.2008 shoqërisë “****” sh.p.k., është përdorur për pagesën e garazhit sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.3.2008 dhe pagesa e këstit të dytë të rikonstruksionit të apartamentit është paguar me kursimet nga pagat.

Në këto kushte, Komisioni rishikoi analizën financiare për të verifikuar mundësitë e ligjshme financiare të subjektit dhe bashkëshortes së tij për të blerë garazhin në datën 13.3.2008 dhe për të paguar këstin e dytë të rikonstruksionit të apartamentit prej 330.000 lekësh në datën 2.8.2008 shoqërisë “****” sh.p.k., duke marrë në konsideratë të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 13.3.2008 – 2.8.2008, pra periudha pas blerjes së garazhit me sip. 22.75 m².

<i>Përshkrimi</i>	Deri më 13.3.2008	2.8.2008
Pasuritë	(612,088)	185,253
Garazh me sip. 22.75 m ² , Tiranë	374,850	
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	-986,938	185,253
Gjendja e likuiditeteve (bankë + <i>cash</i>)	646,423	831,676
Të ardhurat	426,942	907,579
Të ardhura nga paga subjekti	163,799	349,929
Të ardhura nga paga bashkëshortja	223,925	552,826
Të ardhura nga qiratë ap. me sip. 53.5 m ² Tiranë	0	0
Të ardhura nga interesa bankare/BTh/obligacione	39,218	4,824
Shpenzimet	1,062,812	689,515
Shpenzime jetese	113,850	204,930
Shpenzime të pagesave të kredisë (principal + interes) 20.000 euro (NBG Bank)	78,662	104,883
Shpenzime për rikonstruksionin e apartamentit 53.5 m ² sipas mandatpagesave	870,000	330,000

Shpenzime komisione bankare	300	750
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS	0	48,953
Mundësia për kursime	-23,781	32,811

Nga analiza financiare e rishikuar, rezultati për mundësinë financiare për blerjen e garazhit ka ndryshuar nga -361.165 lekë në -23.781 lekë, ndërsa për pagesën e këstit të dytë të rikonstruksionit prej 330.000 lekësh në datën 2.8.2008, subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme referuar rezultatit pozitiv të analizës financiare. Balanca 23.781 lekë nuk konsiderohet penalizuese.

52. Pasuria *truall me sip. 1250 m², banesë me sip. 131.7 m², lagjja “***”, Fier, regjistruar në ZVRPP-në Fier, datë 27.2.2012 sipas vendimit nr. *** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, datë 23.1.2012 për lëshimin e trashëgimisë testamentare. Pjesa takuese: 18.85%. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri. Nga ana e Komisionit janë kryer disa verifikime në lidhje me origjinën, mënyrën e krijimit të kësaj pasurie, deklarimet e subjektit dhe statusin juridik aktual, pasqyruar në mënyrë të hollësishme në rezultatet e hetimit administrativ dhe nga aktet në dosje⁴⁵. Në përfundim nuk u konstatuan problematika apo dyshime në lidhje me këtë pasuri të fituar nga subjekti me trashëgimi dhe u vërtetua se deklarimet e subjektit përputheshim me aktet shkresore të administruara.*

53. Pasuria *truall me sip. 1242 m² dhe truall me sip. 817 m² ndërtesë me sip. 166.2 m² në “***”, Tiranë. Regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, datë 23.11.2012 sipas trashëgimisë testamentare nr. vendimi ***, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. Pjesa takuese: 10/2880. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri. Nga ana e Komisionit janë kryer disa verifikime në lidhje me origjinën, mënyrën e krijimit të kësaj pasurie, deklarimet e subjektit dhe statusin juridik aktual, pasqyruar në mënyrë të hollësishme në rezultatet e hetimit administrativ dhe nga aktet në dosje⁴⁶, në përfundim nuk u konstatuan problematika dhe dyshime në lidhje me këtë pasuri të fituar nga subjekti me trashëgimi dhe u vërtetua se deklarimet e subjektit përputheshim me aktet shkresore të administruara.*

54. Pasuria *apartament 1+1 me sip. 60.18 m² nga të cilat 6.45 m² ambiente të përbashkëta, ***, nr. pasurie ***, z. k. ***Vlorë, blerë datë 23.3.2012. Burimi: (1) mbyllje dhe tërheqje depozite datë 18.1.2012 shuma 875.394 lekë; (2) mbyllje saving plan datë 18.1.2012 shuma 155.656 lekë; dhe (3) kursime nga pagat. Vlera: 2.200.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Regjistruar në emër të Enklid Gjinit. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.*

55. Në lidhje me këtë pasuri, nga aktet në dosje⁴⁷ rezultoi se:

- Sipas regjistrimit nr. *** datë 11.7.2011 figuron e regjistruar në emër të shoqërisë “****” pasuria me nr. ***, apartament me sip. 60.18 m².
- Me kontratë shitjeje nr. *** rep. nr. *** kol. datë 23.3.2012, Enklid Gjini ka blerë pasurinë në çmimin 2.200.000 lekë, likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale, regjistruar në emër të tij sipas regjistrimit nr. *** datë 5.6.2012. DPPP-ja⁴⁸ ka konfirmuar raportimin e transaksionit.
- Blerja e këtij apartamenti është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2012 në të njëjtën mënyrë me të njëjtin çmim, por pa deklaruar burimin e krijimit.
- Sipas kartelës së pasurisë me datë 28.6.2021 kjo pasuri rezulton e regjistruar tërësisht në pronësi të bashkëshortes së subjektit Z. Gj., pasi subjekti ka hequr dorë nga pjesa e tij takuese.

⁴⁵ Shihni aktet në aneksin *** dhe ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁶ Shihni aktet në aneksin ***, *** dhe ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁷ Shihni aktet në aneksin *** dhe ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁸ Shihni aneks *** shkresën nr. *** prot., datë 11.05.2017 të DPPP-së, në dosjen e ILDKPKI-së.

- Nga verifikimi i pagesave për shpenzimin e energjisë elektrike nga subjekti të paraqitura nga FSHU⁴⁹ vërehet se pagesat mujore janë fikse ndërsa në muajt e verës janë në vlera më të larta.

56. Sipas udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2011”, vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave për qytetin e *** është 57.000 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi. Në rastin konkret çmimi i referencës për apartamentin në objekt verifikimi rezulton 57.000 lekë/m² x 60.18 m², në total 3.430.260 lekë, pra duket se apartamenti është blerë më lirë se çmimi i referencës. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim, duke paraqitur kontrata të ngjashme.

56.1. Në parashtrimet e tij, subjekti deklaroi se *vlera e paraqitur në kontratë është reale dhe ka ardhur si rrjedhojë e negociimit të çmimit midis palëve. Apartamenti është blerë në prill, në periudhë gati dimër, dhe pagesa do të bëhej e gjitha menjëherë dhe jo me këste. Në periudhën kur kanë filluar të interesoheshin për të blerë apartament në ***, u vu re se kishte një numër të madh apartamentesh që ofroheshin për shitje (realisht edhe sot një pjesë e madhe e apartamenteve të ndërtuara nuk janë të banuara fare), pasi në atë kohë filloi të zhvillohej ***.* Subjekti ka bashkëngjitur kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.8.2010 me palë shitëse shoqëria “***” ku vlera e apartamentit me sip. 65.44 m² është 2.300.000 lekë. Sipas subjektit, është e vetmja kontratë që mundën të siguronin, pasi nuk kanë kontakte me asnjë banor, pretendim që çmohet i bazuar për sa kohë pasuria objekt verifikimi është një apartament plazhi që u vërtetua të jetë përdorur vetëm gjatë sezonit të verës.

56.2. Në kushtet kur midis çmimit të kontratës së paraqitur dhe çmimit të paguar nga subjekti nuk ka ndonjë diferencë të konsiderueshme dhe nuk ka pasur të dhëna në drejtim të ndonjë konflikti interesi⁵⁰ me shoqërinë “***” sh.p.k. dhe shtetasi R. I., ortak/administrator i saj, pretendimet e subjektit janë çmuar bindëse dhe çmimi i paguar për blerjen e pasurisë nga subjekti është konsideruar si shprehje e vullnetit të lirë të palëve, dhe jo për shkak të ndonjë favorizimi të mundshëm të tij për shkak të detyrës dhe jo vetëm.

57. Në lidhje me burimin e krijimit, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting: (i) mbyllje dhe tërheqje depozite datë 18.1.2012 shuma 875.394 lekë; (ii) mbyllje saving plan datë 18.1.2012 shuma 155.656 lekë; dhe (iii) kursime nga pagat.* Ndërkohë në DPV-në e vitit 2012 ka deklaruar pakësim likuiditetesh me 1.030.000 lekë (që nënkupton mbyllje e depozitës dhe tërheqje nga llogaria e kursimit në ISP Bank, përkatësisht në shumat 875.394 lekë dhe 155.656 lekë) si dhe pakësim *cash* në vlerën 6.000 euro. Nga verifikimet ka rezultuar se deklaratimet e subjektit përputhen me të dhënat bankare.

Sa i takon kursimeve nga paga, subjekti ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* prej 6.000 euro në DPV-në e vitit 2012. Në DPV-në e vitit 2009, ka deklaruar ndër të tjera gjendjen *cash* prej 6.000 euro si rrjedhojë e shitjes së automjetit tip “***” në vlerën 4.000 euro sipas kontratës së shitjes⁵¹ së datës 22.9.2009, deklaruar në DPV-në e vitit 2009. Në DPV-të e viteve 2010 2011, subjekti nuk ka deklaruar pakësim/shtim *cash*. Si e tillë kjo gjendje është konsideruar e mbartur për këto vite deri në vitin 2012 kur subjekti ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* prej 6.000 euro. Nga analiza financiare është vërtetuar që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi për të kursyer gjendjen *cash* gjatë vitit 2009 si dhe të mbulojnë shpenzimet e tjera familjare.

Sa i takon automjetit tip “Mercedes-Benz” të blerë në datën 4.2.2006 në çmimin 500.437 lekë (blerje + zhdoganim), deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2006 dhe të shitur në shtator të

⁴⁹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.6.2021 nga FSHU, në dosjen e Komisionit.

⁵⁰ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.4.2023 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit dhe shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 31.3.2023 nga Prokuroria e Rrethit Fier, në dosjen e Komisionit.

⁵¹ Shihni aneksin *** kontratën nr. *** rep., 2823 kol., datë 22.9.2009, noter D. L., në dosjen ILDKPKI-së.

vitit 2009 në vlerën 4.000 euro, nga analiza financiare vërtetohet blerja me të ardhura të ligjshme.

58. Nga analiza financiare, në përfundim të hetimit administrativ për blerjen e pasurisë objekt verifikimi në datën 23.3.2012, rezultoi një balancë negative 174.901 lekë. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij rezultati si dhe të japë sqarime në lidhje me mosdeklarimin e burimit të DPV-së së vitit 2012.

59. Në parashtrimet e tij, subjekti sqaron se në DPV-në e vitit 2012 dhe në deklaratën *Vetting* janë deklaruar saktësisht të ardhura (“... *përfitur nga trashëgimia ligjore e gjyshes sime*”) në shumat 200.000 lekë dhe 1.500 euro, ndërsa gabimisht në pyetësorin standard është përdorur fjala “kundërvleftë” duke u nënkuptuar që këto dy vlera i përkasin së njëjtës shumë. Për ta mbështetur këtë pretendim, subjekti i referohet faktit se si në deklaratën e vitit 2012 ashtu dhe në atë *Vetting*, për asnjë të ardhur apo pasuri në euro nuk ka vendosur kundërvleftën në lekë, pretendim i cili qëndron. Në këto kushte, subjekti me të drejtë kërkon që Komisioni të konsiderojë si të ardhura edhe shumën 200.000 lekë krahas shumës prej 1.500 euro të konsideruar nga Komisioni, si të ardhura të përfituara nga trashëgimia ligjore dhe të deklaruara në kohë reale. Në këto rrethana, me rishikimin e analizës financiare duke përfshirë edhe shumën prej 200.000 lekësh krahas shumës prej 1.500 euro, si burime të ligjshme, subjekti rezulton me balancë pozitive për blerjen e apartamentit objekt verifikimi.

60. Për sa i përket mosdeklarimit të burimit të blerjes së apartamentit në DPV-në e vitit 2012, subjekti sqaron se në DPV-në e këtij viti prej tij dhe bashkëshortes janë deklaruar saktë shtesa dhe pakësime të pasurive, si dhe të ardhurat vjetore nga pagat e trashëgimia ligjore. Pra, për asetet e krijuara brenda vitit 2012, burimi i krijimit janë të ardhurat e tyre të vitit dhe pakësimet e likuiditeteve në bankë të cilat janë deklaruar rregullisht dhe janë krijuar me të ardhura të ligjshme. Argumentet e subjektit qëndrojnë e për pasojë, mosdeklarimi i burimit në DPV-në e vitit 2012 është pa ndonjë pasojë.

61. Pasuria llogari futura J. Gj., çelur datë 6.10.2010, derdhur deri janar 2017 = 1.248.700 lekë. Interesi neto i fituar deri janar 2017 = 84.928,43 lekë. Burimi: kursime të çdo viti sipas derdhjeve +573.900 lekë interesat e obligacioneve. Vlera: 1.333.628,43 lekë. Pjesa takuese: 50%. Regjistruar në emër të J. E. Gj. Nga verifikimet përputhet deklarimi me të dhënat bankare.

62. Pasuria llogari futura J. Gj., çelur datë 6.10.2010, derdhur deri gusht 2016 = 742.000 lekë. Interesi neto i fituar deri tetor 2016 = 73.251,71 lekë. Burimi: kursime të çdo viti sipas derdhjeve +55.000 lekë interesat e obligacioneve. Vlera në llogari: 815.251,68 lekë. Pjesa takuese: 50% regjistruar në emër të J. E. Gj. Nga verifikimet përputhet deklarimi me të dhënat bankare.

63. Pasuria llogari kartë krediti Tirana Bank, çelur datë 23.8.2006 me fond limit 240.000 lekë. Vlera: 0.00 lekë. Pjesa takuese: 100% Enklid Gjini. Nga verifikimet përputhet deklarimi me të dhënat bankare.

64. Pasuria llogari page në Credins Bank. Vlera: 0.17 lekë. Pjesa takuese: 100% Enklid Gjini. Nga verifikimet përputhet deklarimi me të dhënat bankare.

65. Pasuria obligacione afat 10-vjeçar në Raiffeisen Bank shuma 4.000.000 lekë me interes 9.3% në vit, në datën 21.1.2015. Burimi: kursime nga pagat nga viti 2010 të cilat kanë qenë depozita në: 1. Tirana Bank depozitë e çelur datë 13.1.2009 dhe mbyllur datë 11.1.2011, shuma e tërhequr 1.182.620 lekë (kaluar depozitë 2-vjeçare Credins Bank); 2. Mbyllje depozite afat 3-mujor ISP Bank çelur datë 6.10.2010, mbyllur datë 17.1.2011, shuma e tërhequr 400.000 lekë (kaluar depozitë 2-vjeçare Credins Bank); 3. Credins Bank depozitë 2-vjeçare çelur datë 17.1.2011 shuma 1.600.000 lekë rinovuar depozita datë 17.1.2013 dhe tërhequr datë 19.1.2015

shuma 2.000.000 lekë, e mbyllur datë 24.1.2015 (kaluar obligacione në RZB); 4. Mbyllje depozite afat 1-vjeçar FIB çelur datë 12.12.2013 dhe mbyllur datë 16.1.2015, tërhequr shuma 1.800.000 lekë (kaluar obligacione në RZB). Pjesa takuese: 50% regjistruar në emër të Z. Gj.

66. Nga verifikimet si vijojnë përputhen deklaratimet me të dhënat bankare të bashkëshortes së subjektit. DPPP⁵² konfirmon raportimet e transaksioneve të sipërpërmendura në emër të bashkëshortes së subjektit, të cilat përputhen me të dhënat bankare. Konkretisht Raiffeisen Bank⁵³ konfirmon se Z. Gj. në datën 23.1.2015 ka investuar shumën 4.000.000 lekë në obligacion me afat 10-vjeçar (datë maturimi 23.1.2025). Nga nxjerrja e llogarisë gjatë periudhës 16.1.2015 – 20.10.2016 evidentohen depozitime *cash* në datën 16.1.2015 në shumën 1.800.000 lekë, me përshkrimin “Tërheqje depozite në bankë tjetër”; datë 19.1.2015 në shumën 2.200.000 lekë, me përshkrimin “Mbyllje depozite të Credins Bank”. Në datën 20.1.2015 kalim i shumës 4.000.000 lekë në ankand me afat 10-vjeçar.

Për sa i përket burimeve të deklaruara për krijimin e obligacionit prej 4.000.000 lekësh, nga të dhënat bankare rezultoi se:

- Tirana Bank⁵⁴ ka konfirmuar se Z. Gj. ka pasur llogari me nr. *** në periudhën 2009 – 2014 në monedhën lekë. Sipas nxjerrjes së llogarisë, bashkëshortja e subjektit ka pasur depozitat me afat si më poshtë:

Vlera (lekë)	Datë fillimi	Datë maturimi	Koment
90 000	14.1.2009	14.1.2010	Burim: depozitim <i>cash</i> nga Z. Gjini datë 13.1.2009
210 000	14.1.2009	14.1.2010	
635 249	15.1.2010	17.1.2011	Dep. <i>cash</i> 315 000 lekë nga Z. Gjini datë 14.1.2010; shtuar në principal + interes të dy depozitave të maturuara datë 14.1.2009
300 000	9.6.2010	9.12.2010	Dep. <i>cash</i> 300 000 Z. Gjini
507 311	10.12.2010	10.1.2011	Dep. <i>cash</i> 200 000 Z. Gjini; shtuar princ. + interes dep. maturuar datë 9.12.2010

Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit, rezultoi se në DPV-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar çelje depozitë me afat në Tirana Bank në vlerën 300.000 lekë në datën 14.1.2009, në emër të bashkëshortes dhe pakësimin e gjendjes *cash* me 500.000 lekë.

Shuma prej 1.182.620 lekësh është tërhequr *cash* nga shtetasja Z. Gj. në llogarinë e saj në Tirana Bank në datën 17.1.2011, për t’u depozituar në Credins Bank në datën 17.1.2011, që ka shërbyer si pjesë e depozitës prej 1.600.000 lekësh çelur në këtë bankë po në këtë datë.

- Intesa Sanpaolo Bank⁵⁵ konfirmon se Z. Gj. ka pasur depozitë me afat tremujor në shumën 400.000 lekë me datë fillimi 6.1.2010 dhe maturuar në datën 7.1.2011. Nga nxjerrja e llogarisë bashkëngjitur shkresës së bankës, konfirmohet që balanca prej 400.000 lekësh është krijuar nga depozitimi i pagave në periudhën korrik – tetor 2010. Analiza për krijimin e kësaj depozite pasqyruar në tabelën si më sipër. Shuma prej 400.000 lekësh është tërhequr *cash* nga Z. Gj. nga llogaria e saj pranë Intesa Sanpaolo Bank në datën 7.1.2011, për t’u depozituar në Credins Bank në datën 17.1.2011 dhe shërbyer si pjesë e depozitës prej 1.600.000 lekësh çelur po këtë datë në këtë bankë.

Në tabelën më poshtë përmbledhur analiza financiare për mundësinë e kursimit në periudhat kur janë iniciuar depozitat: në Tirana Bank dhe Intesa Sanpaolo Bank gjatë vitit 2010, të cilat kanë qenë burim i krijimit të depozitës në Credins Bank në vitin 2011:

⁵² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2017 të DPPP, aneks 37 i dosjes ILDKPKI-së.

⁵³ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.6.2021, të Raiffeisen Bank, në dosjen e Komisionit.

⁵⁴ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.6.2021, të Tirana Bank, në dosjen e Komisionit.

⁵⁵ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.6.2021 të ISP Bank, në dosjen e Komisionit.

Përshkrimi	<i>Deri më 15.1.2010</i>	<i>Deri më 9.6.2010</i>	<i>Deri më 10.10.2010</i>	<i>Deri më 10.12.2010</i>
Pasuritë	97,652	363,459	447,851	238,114
Shtesa/pakësime	97,652	363,459	447,851	238,114
Likuiditete	1,565,923	1,929,382	2,377,233	2,615,347
Detyrime	- 19,521	- 100,148	- 81,269	- 41,151
Shlyerje kredia NBG	- 19,521	- 100,148	- 81,269	- 41,151
Pasuri neto	117,173	463,607	529,120	279,265
Të ardhura	197,984	913,091	1,566,705	1,152,890
Subjekti	69,732	346,920	341,874	163,800
Bashkëshortja	103,561	521,997	411,189	209,685
Dhuratë nga gjyshja sipas deklaratës noteriale (21.1.2011) dhënë korrik 2010	-	-	693,850	-
Të ardhura nga periudha të mëparshme të analizës		44,174	119,792	772,095
Të ardhura int. bankarë	24,691	-	-	7,310
Shpenzime	34,713	310,442	250,090	183,566
Shpenzime jetike	22,770	227,700	182,160	91,080
Shpenzime interesa kredie NBG	10,018	47,545	36,885	17,926
Shpenzime kom. bankare	-	750	1,074	250
Shpenzime udhëtimi prokuror Fier	1,925	19,250	15,400	7,700
Shpenzime TIMS	-	15,197	14,571	66,610
Mundësia për kursim	46,099	140,967	808,670	726,634

- Credins Bank⁵⁶ konfirmon se Z. Gj. është kliente e bankës dhe ka pasur depozita 2-vjeçare prej 1.600.000 lekësh në periudhën 2011 – 2013 dhe prej 1.810.240 lekësh në periudhën 2013 – 2015. Në dosjen e ILDKPKI-së⁵⁷ gjendet e depozituar nxjerrje llogarie dhe librezë depozite pranë Credins Bank, ku konfirmohet depozitimi *cash* i shumës 1.600.000 lekë dhe çelje e depozitës me afat në datën 17.1.2011 e maturuar në datën 17.1.2013 dhe rivendosur në depozitë 2-vjeçare vlera 1.810.240 (principali + interesin e përfituar). Vlera prej 2.000.000 lekësh është tërhequr datën e maturimit të depozitës 19.1.2015 nga bashkëshortja e subjektit për t'u depozituar në Raiffeisen Bank në datën 19.1.2015.

- Fibank⁵⁸ konfirmon se Z. Gj. ka pasur llogari rrjedhëse dhe depozitash me statusin aktual të mbyllur. Sipas dokumentacionit bashkëngjitur shkresës së Fibank (kontrata depozitash me afat dhe nxjerrje llogarie rrjedhëse), konfirmohet: (i) çelja e depozitës me afat në datën 12.12.2013 në vlerën 1.033.533,10 e cila është maturuar në datën 12.12.2014; (ii) në datën 12.12.2014 është depozituar *cash* shuma prej 767.000 lekësh, e cila i është shtuar principalit të depozitës së maturuar dhe shuma prej 1.800.000 lekësh është vendosur në depozitë me afat dyvjeçar. Depozita prej 1.800.000 lekësh është tërhequr *cash* nga Z. Gj. në datën 16.1.2015 për t'u depozituar në Raiffeisen Bank në datën 16.1.2015.

Në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për çeljen e depozitës pranë Fibank në vlerën 1.000.000 lekë më 12.12.2013, nga nxjerrja e llogarive të bashkëshortes së subjektit, vërehet se shuma prej 700.000 lekësh është tërhequr *cash* në datën 12.12.2013, nga të cilat 492.143 lekë kanë qenë gjendje e akumuluar në këtë llogari gjatë vitit 2013 nga paga e saj dhe interesat e përfituara, ndërsa diferenca ka qenë gjendje në llogarinë e pagës. Për Komisionin ka qenë e paqartë cili ka qenë burimi i diferencës prej 300.000 lekësh, për këtë arsye subjektit

⁵⁶ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.7.2021 të Credins Bank, në dosjen e Komisionit.

⁵⁷ Shihni aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁸ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 31.5.2021 të ISP Bank, në dosjen e Komisionit.

iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këto konstatime. Nga analiza financiare për krijimin e depozitave në datat respektive pranë Fibank në vitet 2013 dhe 2014, rezultoi një balancë negative prej 97.093 lekësh për vitin 2013 dhe 29.448 lekë për vitin 2014.

Në parashtrimet e tij subjekti kërkoi (pa u shprehur specifikisht për burimin e diferencës prej 300.000 lekësh) që në analizën financiare të përfshihen edhe të ardhurat nga qiraja e apartamentit 1+1 në Tiranë, të cilat kanë qenë në vlerën 216.000 lekë në vitin 2013. Sa i takon këtij pretendimi, dhe nëse nuk merren në konsideratë të ardhura nga qiratë, balancat negative janë në vlera të pakonsiderueshme dhe nuk afektojnë analizën financiare në atë masë që të penalizojë subjektin e rivlerësimit (trajtuar në paragrafin 75 të këtij vendimi).

67. Nga sa më sipër, konfirmohet se obligacionet në vlerën 4.000.000 lekësh kanë pasur si burim depozitat që shtetasja Z. Gj. ka pasur pranë Tirana Bank, Intesa Sanpaolo Bank, Credins Bank dhe Fibank. Totali i depozitave të tërhequra nga Fibank dhe Credins Bank, të depozituara në Raiffeisen Bank respektivisht në datat 16.1.2015 dhe 19.01.2015 që kanë shërbyer për investimin në obligacionin 10-vjeçar kanë qenë në vlerën 3.800.000 lekë (tërhequr 2.000.000 lekë nga Credins Bank dhe 1.800.000 lekë nga Fibank). Për të mundësuar shumën e obligacioneve prej 4.000.000 lekësh, duket se është depozituar edhe shuma prej 200.000 lekësh në datën 19.1.2015 pranë Raiffeisen Bank. Duke qenë se në DPV-në e vitit 2014, nuk është deklaruar likuiditet në *cash*, subjekti nuk ka pasur mundësi për të krijuar këtë shumë në datën 19.1.2015. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

68. Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi se shuma rreth 200.000 lekë e derdhur në Raiffeisen Bank në datën 19.1.2015 e ka burimin: (i) tërheqje nga llogaria në vlerën prej 16.000 lekësh; (ii) tërheqje nga llogaria e bashkëshortes në vlerën 50.000 lekë; (iii) diferenca janë teprica të ngelura në banesë nga pagat dhe një pjesë e tyre kanë qenë të mbledhura si kursime *cash* të fëmijëve. Sa i takon pretendimit në lidhje me kursimet e mbajtura *cash* në banesë, në analizën financiare për mundësinë e krijimit të shumës prej 200.000 lekësh në datën 19.5.2015, janë konsideruar si pasuri ndryshimet e likuiditeteve në periudhën 1.1.2015 – 19.1.2015, pra këtu përfshihen ndryshimet në balancat e llogarive bankare, ku janë të përfshira edhe tërheqjet *cash* që cilëson subjekti në parashtrimet e tij. Meqenëse subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në fund të vitit 2014, pretendimet e tij mbeten në nivel deklarativ dhe si të tilla nuk mund të merren në konsideratë.

69. Pasuria depozitë me afat 1-vjeçar në Credins Bank, çelur datë 30.12.2015, shuma 415.000 lekë kursime. Gjendja: 23.1.2017 = 420.644 lekë. Pjesa takuese: 100% në emër të Z. Gj.

69.1. Nga të dhënat bankare pranë Credins Bank konfirmohet i saktë ky deklaram. Nga nxjerrja e llogarisë nr. ***, duket se në datën 30.12.2015 është depozituar *cash* vlera prej 415.000 lekësh nga shtetasja Z. Gj. Në datën 30.12.2016 janë kredituar interesa dhe debituar tatim mbi këto interesa të fituara nga depozita prej 415.000 lekësh, e cila është rinovuar sërish. Nga analiza financiare rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka pasur të ardhura të ligjshme me të ardhura nga pagat për të investuar në depozitën 415.000 lekë pranë Credins Bank.

70. Pasuria llogari kursime ISP Bank, gjendja datë 23.1.2017, 270.814,83 lekë. Pjesa takuese: 100% në emër të Z. Gj***. Nga të dhënat e ISP Bank konfirmohet i saktë deklarimi i subjektit.

71. Pasuria automjet tip “***”, vit prodhimi 2005, blerë në datën 2.12.2016, targë ***. Vlera: 200.000 lekë. Pjesa takuese: 100% në emër të Z. Gj***. Nuk është deklaruar burimi i krijimit. Nga aktet shkresore⁵⁹ rezulton se:

⁵⁹ Shihni dokumentet në aneksin *** dhe *** në dosjen e ILDKPKI-së si dhe dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.6.2021 nga DPSHTRR-ja, në dosjen e Komisionit.

- Ky automjet është aktualisht i regjistruar në pronësi të bashkëshortes së subjektit Z. Gj. blerë me kontratë shitblerjeje pasurie të luajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.12.2016 nga shtetasi D. P. kundrejt shumës 200.000 lekë, paguar jashtë zyrës noteriale. Sipas dokumentit në gjuhën gjermane që mban datën 11.11.2016 automjeti është blerë nga shtetasi D. P. në shumën 600 euro, e më pas është zhdoganuar në datën 24.11.2016 prej këtij shtetasi në shumën 25.259 lekë. Nga verifikimi në sistemin elektronik të AMF-së, rezulton se policia e parë i përket vitit 2016 dhe nuk ka pasur përdorues të tjerë përveç subjektit dhe bashkëshortes. Në lidhje me shtetasin D. P., nga verifikimet e kryera pranë prokurorive Tiranë⁶⁰, Fier⁶¹ dhe SPAK⁶², nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi e as përfshirje të këtij shtetasi në veprimtari të krimit të organizuar. Blerja e këtij automjeti është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2016 në të njëjtën mënyrë, pa deklaruar burimin e krijimit.

- Nga analiza financiare e kryer në përfundim të hetimit administrativ, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi për të kryer investimin në blerjen e automjetit në datën 2.12.2016 dhe mbuluar shpenzimet e tjera familjare.

- Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me mosdeklarimin nga bashkëshortja të burimit të krijimit të mjetit në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2016. Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi se në DPV-në e vitit 2016 bashkëshortja ka deklaruar shtesa dhe pakësime të pasurive, si dhe të ardhurat vjetore nga pagat, qiraja dhe interesat bankarë. Shuma 200.000 lekë është tërhequr në datën 2.12.2016 nga llogaria e saj në ISP Bank. Pra, për asetet e krijuara brenda vitit 2016, burimi i krijimit janë të ardhurat e deklaruara po brenda vitit 2016, burim që vërtetohet me të ardhura të ligjshme pas analizës financiare të kryer. Sipas subjektit, mospasqyrimi i burimit të mjetit në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2016 është thjesht harresë. Këto deklarime të subjektit mbështeten me të dhënat bankare të llogarisë së bashkëshortes së tij. Në këto kushte, mosdeklarimi i burimit në DPV-në e vitit 2016, u konsiderua si një pasaktësi pa pasoja.

72. Në rubrikën “Detyrime financiare” është deklaruar kredi në shumën 20.000 në NBG Bank marrë në periudhën 7.12.2007 – 7.12.2017, kësti mujor 212,58 euro (i pandryshueshëm), me afat 10-vjeçar në 120 këste mujore të barabarta 213 euro/muaj. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer 2.282,96 euro. Me të dhënat bankare të NBG Bank, konfirmohen të saktë deklarimet e subjektit.

Deklarimi i bashkëshortes Z. Gj.

73. Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të njëjtat pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit sikurse trajtuar më lart, si dhe, pasurinë *apartament banimi 3+1, me sip. 81 m², Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë. Përfitur nga privatizimi. Pjesa takuese ¼ me prindërit dhe vëllain.* ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri. Gjatë hetimit administrativ, nëpërmjet akteve shkresore⁶³ u vërtetua se bashkëshortja e subjektit Z. Gj. ka qenë bashkëpronare me ¼ pjesë takuese me dy prindërit e saj dhe vëllain të një apartamenti me sip. 81 m², me nr. pasurie ***, në rrugën “****”, Tiranë, të përfitur nga privatizimi. Me dëshminë e trashëgimisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.1.2020 u përcaktuan trashëgimtarët e radhës së parë të trashëgimlënësit G. Z. 4 fëmijët e tij, të cilët trashëgonin ¼ pjesë takuese të pasurisë trashëgimore secili. Në datën 4.2.2020 pasuria u regjistrua në pronësi të 4 fëmijëve, ku Z. Gj. rezultoi me 3/8 pjesë takuese.

⁶⁰ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.5.2023 nga Prokuroria e Rrethit Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁶¹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.5.2023 nga Prokuroria e Rrethit Fier, në dosjen e Komisionit.

⁶² Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 31.5.2023 nga SPAK, në dosjen e Komisionit.

⁶³ Shihni dokumentet në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.7.2021, nga ASHK Tirana Jug, në dosjen e Komisionit.

Me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.9.2020 kjo pasuri iu shit shtetasit A. Xh. dhe referuar dokumentacionin bashkëngjitur përgjigjes së ASHK Tirana Jug aktualisht rezulton e regjistruar në pronësi të këtij shtetasi.

74. Pasuria llogari page ISP Bank, gjendja datë 23.1.2017, 5.781,82 lekë. Pjesa takuese: 100% në emër të Z. Gj. Përputhet deklarimi me të dhënat e ISP Bank.

75. Në lidhje me të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Tiranë

75.1. Gjatë hetimit administrativ, rezultoi se:

- Subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara nga dhënia me qira në DPV-të e viteve 2008, 2009, 2013 dhe 2016 dhe në deklaratën *Vetting*.

- Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se gjatë këtyre viteve kanë përfituar të ardhura nga dhënia me qira mujore 20.000 lekë e apartamentit të banimit nr. *** (të përshkruar në paragrafin 30), për të cilat janë paguar tatimet nga bashkëshortja e tij në sportelet e postës, por nuk disponohen mandatpagesa. Ndërsa për vitin 2016 është paguar tatim mbi qiranë në shumën 3.000 lekë në muaj. Për të vërtetuar marrëdhënien e qirasë subjekti ka paraqitur tri kontrata qiraje.

- DPT-ja⁶⁴ konfirmon pagesat e tatim-burimit për qiratë e apartamentit me sip. 53.5 m² gjatë periudhës tetor 2016 – maj 2021.

- Gjatë hetimit, i është kërkuar subjektit të vërtetojë me dokumente pagesat e tatimit mbi të ardhurat nga qiratë përpara vitit 2016. Në përgjigjet e pyetësorëve nr. 3 dhe nr. 4, subjekti ka paraqitur dokumente shkresore që vërtetojnë se detyrimet tatimore janë paguar datë 21.3.2023, pas dërgimit të pyetësorit nr. 3. Për këtë arsye, në përfundim të hetimit administrativ të ardhurat nga qiraja për vitet 2008 – 2009 dhe 2013 nuk janë konsideruar si të ardhura të ligjshme.

75.2. Në parashtrimet e tij, pas njohjes me rezultatet e hetimit, subjekti vijon të japë të njëjtat sqarime për sa i përket të ardhurave nga qiraja dhe pagesës së tatimit në burim për këto të ardhura, të cilat janë të deklaruara nga kohë reale në DPV-të e viteve 2008, 2009 dhe 2013 në vlerën 20.000 lekë/muaj. Sipas tij, tatimet mbi të ardhurat nga qiraja janë paguar nga bashkëshortja pranë sportelit të Postës Qendrore, mandate të cilat nuk i disponojnë. Më tej, ai sqaron se nga viti 2015 e në vazhdim bashkëshortja është interesuar vazhdimisht pranë DRT Tiranë për gjetjen e këtyre mandateve, por ka qenë e pamundur gjetja e pagesave të kryera, pasi: pagesa është bërë në sportelet e Postës Qendrore (Excel) dhe jo nëpërmjet sistemit bankar; kontrata e qirasë nuk ka qenë e regjistruar në DRT Tiranë dhe se bashkëshortja nuk ka pasur përgjegjësi për deklarimin DIVA. Subjekti ka deklaruar se në pamundësi të gjetjes së pagesave pranë DRT Tiranë, bashkëshortja e tij ka bërë sistemim veprimesh duke aksesuar formularin për përgjegjësinë tatimore të tatimit në burim mbi qiranë ku u bë e mundur ripagesa e tatimit + kamatëvonesat + gjobat për të ardhurat nga qiraja për vitet 2008, 2009 dhe 2013. Sipas subjektit referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, tatimpaguesi mund t’i shlyejë detyrimet tatimore edhe me vonesë, duke paguar gjobën përkatëse. Po kështu, sipas tij edhe neni D i Aneksit të Kushtetutës nuk e lidh pagimin e detyrimeve tatimore me ndonjë afat kohor të përcaktuar. Subjekti sjell në vëmendje të Komisionit vendimin nr. 15/2021 të Kolegjit ku orientohet se: “...në referim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të ardhurave të krijuara, Kolegji çmon se vlerësimi i tyre do të duhet të bëhet duke konsideruar disa rrethana. Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Së dyti,

⁶⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 27.5.2021 të DPT-së.

në konsideratë të organeve të rivlerësimit duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtij kriteri, do të duhet të vlerësohen rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie apo një qëllim për t'u arritur”.

75.3. Në përfundim të procesit, në analizë të parashtrimeve të subjektit, sikurse edhe Kolegji orienton, Komisioni i referohet disa rrethanave. Konkretisht:

- Subjekti ka deklaruar në DPV-të e viteve 2008, 2009 dhe 2013 të ardhura nga qiratë si dhe ka dokumentuar marrëdhënien e qirasë, prova të cilat vërtetojnë që janë përfituar të ardhura nga qiratë.

- Në fillim të procesit të rivlerësimit (përgjigje e pyetësorit standard) subjekti ka deklaruar se bashkëshortja e tij ka paguar tatimin mbi të ardhurat nga qiratë në sportelet e postës dhe jo nëpërmjet sistemit bankar, duke argumentuar se kjo ka ndodhur për shkak se bashkëshortja nuk ka qenë e ngarkuar me përgjegjësi për deklarimin DIVA. Megjithatë, pretendimi se nuk i disponojnë mandatpagesat mbetet në nivel deklarativ, dhe për pasojë, nuk ka të dhëna nëse pagesa e detyrimit tatimor është kryer në kohë reale. Në këto kushte, subjekti ka përmbushur detyrimin (për herë të dytë sipas tij) gjatë procesit të rivlerësimit, ndërkohë që ligji tatimor nuk e pengon tatimpaguesin të shlyejë detyrimet tatimore edhe me vonesë.

75.4. Në këto kushte, si dhe referuar faktit që shuma e tatimit mbi të ardhurat nga qiratë prej 68.000 lekësh në total (pra për vitet 2008, 2009 dhe 2013) nuk është ndonjë shumë e konsiderueshme, Komisioni nuk mund të arrijë në përfundimin që mospagimi në kohë i detyrimeve tatimore është bërë me qëllim shmangien e këtij detyrimi. Në këto kushte, në rast konsiderimi të të ardhurave nga qiratë, rezultati i analizës financiare do të ndryshojë në këtë mënyrë: (i) viti 2008 nga 541.260 lekë në vlerën 721.260 lekë; (ii) viti 2009 nga 495.577 lekë në vlerën 711.577 lekë; dhe (iii) viti 2013 nga -178.404 lekë në vlerën 37.596 lekë. Ndërsa, në rast se të ardhurat nga qiratë nuk do të konsiderohen të ligjshme, impakt negativ ka vetëm viti 2013, balanca negative e të cilit nuk është e atij niveli që të penalizojë subjektin e rivlerësimit.

76. Gjatë procesit janë kryer hetime në lidhje me disa konstatime të tjera, trajtuar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ për të cilat nuk kanë rezultuar problematika. Sa i takon një automjeti në pronësi të bashkëshortes së subjektit me targë ***, blerë pas deklaratës *Vetting*, në datën 6.4.2017, është vërtetuar se ka pasur një kontratë huapërdorjeje me datë 29.10.2016, të lidhur mes shtetasit Enklid Gjini dhe shtetasit A. K. për ta përdorur këtë automjet pa ndonjë afat. Duke qenë se përdorimi i tij nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting*, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim. Në parashtrimet e tij, subjekti ka shpjeguar ashtu si në pyetësorin standard, se kjo prokurë është bërë me qëllim përdorimin e mjetit vetëm për ta parë se si punonte mjeti dhe në rast se do të pëlqej do të vendosej për blerjen e tij, sikurse edhe ndodhi. Sipas tij, nuk iu kushtua rëndësi revokimit të prokurës duke ditur që ai dhe bashkëshortja do të ishin blerësit e mjetit kur të shitej, dhe se, nuk është menduar se duhet të deklaronte përdorimin dyjavor në deklaratën *Vetting* dhe duke qenë një mosdeklarim krejtësisht i paqëllimshëm. Në përfundim të procesit, referuar periudhës dyjavore të përdorimit të mjetit deri në plotësimin e deklaratës *Vetting*, faktit që në periudhën para blerjes së mjetit policat e sigurimit tregojnë pronar shtetasin A. K., faktit që në sistemin TIMS nuk rezultuan udhëtime të subjektit apo bashkëshortes së tij me këtë automjet, si dhe, faktit që automjeti i dhënë në përdorim u ble nga bashkëshortja e subjektit, pretendimet e subjektit u vlerësuan të arsyeshme dhe nuk ngrihen dyshime për shkak të mosdeklarimit të përdorimit të mjetit në deklaratën *Vetting*.

77. Nga Komisioni është kryer analiza financiare bazuar në vlerën e pasurive, të ardhurat dhe shpenzimet dhe në përfundim të hetimit administrativ, sa i takon periudhës para fillimit të detyrës, nga analiza financiare e kryer në mënyrë kumulative, subjekti ka justifikuar me të

ardhura të ligjshme pasuritë dhe shpenzimet. Sa i takon periudhës nga emërimi në detyrë datë 1.7.2004 deri në datën 31.12.2016, nga analiza financiare e kryer në përfundim të hetimit administrativ, shuma e viteve me balancë negative ishte 619.994 lekë.

77.1. Në parashtrimet e tij subjekti ka ngritur pretendime të cilat janë analizuar në mënyrë të detajuar rast pas rasti në këtë vendim. Sa i takon balancës negative të vitit 2011 prej -111.991 lekësh (e patrajtuar më sipër), subjekti ka ngritur disa pretendime të cilat mbeten në nivel deklarativ. Në këto kushte, si dhe referuar deklarimeve të subjektit në DPV-të e viteve 2010 dhe 2011, këto pretendime nuk u morën në konsideratë. Pas rishikimit të analizës financiare, balanca negative prej -619.994 lekësh behet -290.394 lekë (nëse nuk merren në konsideratë të ardhurat nga qiratë e apartamentit), pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, balancë e cila nuk mund të konsiderohet si shkak për penalizim të subjektit.

Periudha	1. Pasuri	2. Të ardhura	3. Shpenzime	Mundësia për kursime (2-1-3)
<i>1996 deri më 1.7.2004</i>	4,334,743	6,631,869	1,690,591	606,535
<i>Nga 1.7.2004</i>	1,061,582	1,519,589	340,946	117,061
<i>2005</i>	881,968	2,101,527	630,950	588,609
<i>2006</i>	887,873	2,165,948	753,630	524,445
<i>2007</i>	2,708,288	4,329,278	728,490	892,500
<i>2008</i>	-533,949	2,220,645	2,213,335	541,260
<i>2009</i>	943,709	2,655,425	1,216,139	495,577
<i>2010</i>	1,027,525	2,967,443	1,053,074	886,845
<i>2011</i>	1,250,142	2,321,116	1,182,964	-111,991
<i>2012</i>	664,134	2,604,504	1,648,769	291,600
<i>2013</i>	1,482,826	2,519,112	1,214,690	-178,404
<i>2014</i>	1,054,970	2,458,167	1,386,894	16,303
<i>2015</i>	1,169,064	2,835,143	1,581,812	84,266
<i>2016</i>	927,134	2,847,140	1,811,499	108,508

Kontrolli i figurës

78. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/206. Për këtë qëllim AKSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 7.11.2017 mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Enklid P. Gjini, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 9.6.2021 të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

79. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur në lidhje me kriterin e figurës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer verifikimet si vijojnë:

- Pas kërkesës për përditësim informacioni, AKSIK-ja informoi se nuk ka të dhëna të përditësuara.

- Referuar një informacioni konfidencial, i është kërkuar AKSIK-së që pas verifikimeve të vlerësohet nëse ka vend për rishikimin e raportit të parë. Ky institucion me shkresë të datës 15.6.2023, ka vënë në dispozicion raportin me datë 13.6.202 të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. *** datë 14.6.2023 të KDZH-së, me të cilin ka ndryshuar konstatimin fillestar nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Enklid P. Gjini në papërshtatshmëri.

- Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuar të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim. Në parashtrimet e tij, subjekti u shpreh se në kushtet kur raporti i dytë i AKSIK-së nuk është i deklasifikuar tërësisht, e ka të pamundur të japë përgjigje. Sipas tij, pavarësisht se Komisioni i ka kërkuar të japë shpjegime, nuk i ka njoftuar asnjë gjetje e cila të rezultonte nga hetimi administrativ. Në konkluzion të parashtrimeve, subjekti ka pretenduar se raporti i dytë i AKSIK-së nuk ka asnjë bazë, nuk jep asnjë të dhënë, asnjë rrethanë, provë apo veprim konkret për ekzistencën e ndonjë kontakti të papërshtatshëm apo për përfshirje në veprimtari korruptive. Sipas tij ai ka plotësuar me saktësi dhe vërtetësi deklaratën e kontrollit të figurës.

- Bazuar në informacionet e marra pranë organeve ligjzbatuese, janë verifikuar dy çështje penale (trajtuar në rubrikën e vlerësimit profesional), nga analizimi i të cilave nuk u konstatuan të dhëna që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

- Pas kërkesës së Komisionit SPAK-u⁶⁵ ka informuar se:

i) Në emër të shtetasit Enklid Gjini nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

ii) Ndaj tij është regjistruar kallëzimi nr. ***, viti 2019 i shtetasës L.P., për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Në zbatim të vendimit nr. ***, datë 8.11.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, është regjistruar procedimi penal nr. *** i vitit 2019. Pas kryerjes së hetimeve të këtij procedimi është vendosur dërgimi për kompetencë në SPAK dhe është regjistruar me numrin ***, datë 20.12.2019. Ky procedim është në fazën e hetimit dhe nuk ka emër të regjistruar. Në lidhje me vijueshmërinë e trajtimit të këtij procedimi penal, SPAK-u⁶⁶ informoi se pas kryerjes së hetimeve është vendosur që çështja të dërgohet në gjykatë me kërkesë pushimi me datë 11.1.2022. GJPKKO-ja me vendimin nr. ***, datë 20.4.2022 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 20.12.2019. Pas ankimit të këtij vendimi në Gjykatën e Apelit nga kallëzuesja, kjo gjykatë ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 20.4.2022 dhe kthimin e akteve në të njëjtën gjykatë, e cila me vendimin nr. ***, datë 17.2.2023 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 20.12.2019.

iii) Ndaj tij është regjistruar kallëzimi me kallëzuese E. D., i cili është vendosur të dërgohet për vlerësim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës. Pas kërkesës së Komisionit mbi vijueshmërinë e trajtimit të këtij procedimi penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës⁶⁷ ka informuar se në lidhje me këtë material hetimor, me datë 30.12.2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal nga prokurori D. P. Në lidhje me vendimin e mosfillimit është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës, vendim i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës.

- Referuar të dhënave të sistemit TIMS, nga verifikimet e kryera në lidhje me kontakte të papërshtatshme të subjektit mbi përfshirje të pronarëve apo përdoruesve të mjeteve në

⁶⁵ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.6.2021 nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

⁶⁶ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.4.2023 nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

⁶⁷ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.5.2023 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, dhe dokumentacionin bashkëngjitur saj në dosjen e Komisionit.

veprimtari të krimit të organizuar, nga informacioni i dhënë prej SPAK-ut⁶⁸ nuk rezultuan shtetas të tillë në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016.

80. Në përfundim të procesit, në kushtet kur nga hetimi: (i) nuk u konstatuan mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave; (ii) nuk ka pasur asnjë të dhënë dhe nuk u gjend ndonjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar dhe as prova e fakte që cenojnë figurën e subjektit apo besimin e publikut sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, të dhëna që mungojnë e të jenë paraqitur edhe në raportin e dytë të AKSIK-së, i cili ka ndryshuar raportin e parë pa iu referuar ndonjë të dhëne konkrete, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit Enklid Gjini ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi i aftësive profesionale

81. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr.84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Enklid Gjini, bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me nr. *** prot., datë 17.12.2020 protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 4.2.2021; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti për analizimin e aftësive profesionale kryer nga KLP-ja

82. Raporti për analizimin e aftësive profesionale kryer nga Këshilli i Lartë Prokurorisë është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjet penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga burimet arkivore të prokurorisë/ve. Në përfundim, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit, si më poshtë.

Në lidhje me aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Enklid Gjini shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ai identifikon drejt normën ligjore të zbatueshme dhe argumenton arsyet e zbatimit e saj në rastin konkret.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti në përgjithësi shfaq aftësi në arsyetimin ligjor të akteve. Këtë e tregon mënyra e pasqyrit të rrethanave të faktit, analiza e provave dhe ballafaqimi i tyre me bazën ligjore të aplikueshme, si dhe përpilimi i kërkimeve të prezantuara në këto akte në mënyrë të saktë dhe të duhur, sipas kërkesave të ligjit. Vendimmarrja e prokurorit, subjekt vlerësimi, e pasqyruar në pjesën arsyetuese është e qartë dhe të kuptueshme, ku evidentohet referimi në bazë ligjore.

Në lidhje me aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

⁶⁸ Shihni shkresat kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.5.2023, nr. *** prot., datë 4.4.2023 dhe nr. *** prot., datë 31.5.2023 nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

Subjekti Enklid Gjini ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, ku i ka kryer hetimet si dhe drejtuar e kontrolluar veprimtarinë hetimore brenda një afati të arsyeshëm në raport me kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e çështjeve.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti ka kryer veprimet e duhura hetimore në kohë të arsyeshme. Nga ana e tij është realizuar mbledhja në kohë e provave dhe burimeve të provave të domosdoshme, të cilat janë vënë në bazë të akuzave të ngritura, të cilat janë dërguar për gjykim, si dhe sa i takon vendimmarrjes është kujdesur në njoftimin e subjekteve dhe palëve të interesuara.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Subjekti ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve dhe rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të sakta, të strukturuar, në respektim të normave të drejtshkrimit.

Në lidhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga ana e prokurorit rezulton se janë përmbushur me korrektësi kërkesat për disiplinën e punës dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit. Nga aktet e dosjeve të shqyrtuara për efekt të procesit të rivlerësimit konstatohet nivel i pëlqyeshëm përgjegjshmërie, në administrimin e duhur të akteve ligjore nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Ai ka pasqyruar një komunikim e bashkëpunim korrekt me kolegët, duke shkëmbyer njohuritë dhe përvojën profesionale me ta, por njëkohësisht edhe sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratës, ka qenë korrekte duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre.

b) Integriteti

Nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Subjekti, gjatë periudhës së rivlerësimit nuk ka pasur masa disiplinore.

c) Paanësia

Nuk rezulton të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar apo të jenë diskutuar cenim të të drejtave të pjesëmarrësve në proces apo të grupeve shoqërore vulnerable. Nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me aftësitë personale dhe angazhimin profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Subjekti i rivlerësimit Enklid Gjini në periudhën e vlerësimit ka shfaqur aftësi komunikuese të mira. Bashkëpunimi, sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratën, ka qenë korrekte duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre. Ka shfaqur një sjellje shumë të mirë, i komunikueshëm dhe duke shfaqur aftësi profesionale në diskutime teknike, për çështje të ndryshme. Ka aftësi shumë të mira komunikimi, bashkëbisedon pa rezerva dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Ka cilësi të mira bashkëpunuese dhe tregohet i gatshëm të punojë në grup dhe me agjenci të tjera ligjzbatuese dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët. Ka shfaqur

aftësi dhe këmbëngulje në organizimin me efektivitet të burimeve materiale dhe njerëzore të prokurorisë, duke i menaxhuar me përsosmëri këto burime.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, për periudhën objekt vlerësimi subjekti Enklid Gjini nuk ka paraqitur të dhëna mbi angazhimin e tij në aktivitete profesionale.

Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:

83. Tre vendimet e përzgjedhura nga subjekti si vijojnë: vendim i datës 4.3.2014 për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 10.2.2014; diskutim përfundimtar i paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për çështjen penale nr. ***, viti 2014; dhe vendim i datës 29.9.2016 për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 15.12.2015. Për dy prej këtyre vendimeve, me njoftimin e rezultateve të hetimit iu kërkua të japë sqarime e të paraqesë dokumente, si vijon:

83.1. Lidhur me faktin nëse ndaj vendimit të datës 4.3.2014 për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 10.2.2014 (dokumenti i parë) është paraqitur ankim. Me shkresë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, paraqitur nga subjekti në parashtrime, vërtetohet se ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim.

83.2. Lidhur me faktin nëse ndaj vendimit të datës 29.9.2016 për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 15.12.2015 është paraqitur ankim. Me shkresë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, paraqitur nga subjekti në parashtrime vërtetohet se ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, datë 15.12.2015, është ushtruar ankim nga shtetasja D. Z. dhe me vendimin nr. ***, datë 13.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur rrëzimi i kërkesës. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 3.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 13.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bashkëngjitur është dërguar gjithashtu edhe kopja e vendimit nr. ***, datë 13.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

84. Pesë dosjet e përzgjedhura me short si vijojnë: dosja nr. 1 – kallëzimi penal nr. *** datë 1.4.2015, mosfilluar në datën 1.6.2015; dosja nr. 2 – procedimi penal nr. *** datë 24.7.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pushuar në datën 25.9.2015; dosja nr. 3 – procedimi penal nr. ***, datë 2.5.2016 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pushuar në datën 1.7.2016; dosja nr. 4 – procedimi penal nr. ***, datë 1.1.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, dërguar për gjykim në datën 28.1.2014; dosja nr. 5 – procedimi penal nr. ***, datë 23.3.2015 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dërguar për gjykim në datën 15.10.2015. Për tre prej këtyre dosjeve, subjektit iu kërkuan sqarimet, si vijojnë:

84.1. Në lidhje me dosjen nr. 1, nga analiza e akteve prej KLP-së, ishte konstatuar se vendimi i mosfillimit të procedimit penal të datës 1.6.2015 ishte marrë tej afatit 1-mujor të përcaktuar në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Për këtë konstatim, në parashtrimet e tij, subjekti ka konfirmuar faktin se ky kallëzim penal është regjistruar në organin e prokurorisë në datën 1.4.2015, por është marrë në dorëzim prej tij në datën 10.4.2015, dhe deklaroi se kjo vonesë së bashku me ngarkesën e madhe në punë kanë ndikuar në marrjen e vendimit pas kalimit të afatit 1-mujor. Sipas tij, nga kjo vonesë nuk ka ardhur asnjë pasojë dhe nuk janë cenuar të drejtat e subjekteve të procedimit, të cilëve u është njoftuar vendimi i mosfillimit. Për të mbështetur pretendimet e tij subjekti ka paraqitur: (i) shkresën nr. *** prot., datë 20.6.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ku konfirmohet se ndaj vendimit nr. ***, datë 1.4.2015 nuk është ushtruar ankim nga palët P. H. e K. H.; (ii) kopje të vendimit të mosfillimit të procedimit për kallëzimin penal nr. ***, viti 2015, shoqëruar me shkresën e njoftimit të vendimit nr. *** prot. (E. Gj.), datë 9.7.2015; (iii) kopje të regjistrimit të njoftimit/kallëzimeve të veprave penale të Prokurorisë së vitit 2015. Në përfundim të procesit,

argumentet e subjektit u vlerësuan bindëse pasi ka provuar se kallëzimi është marrë prej tij 10 ditë me vonesë nga data e regjistrimit në organin e prokurorisë 1.4.2015, dhe se, nga vonesa e konstatuar prej një muaji nuk kanë ardhur pasoja për palët të cilët nuk kanë ushtruar ankim ndaj vendimit.

84.2. Në lidhje me dosjen nr. 2, me kërkesë të Komisionit, në parashtrimet e tij subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 20.6.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas së cilës ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, datë 24.7.2015 nuk është ushtruar ankim nga palët D. B. dhe OSHEE.

84.3. Në lidhje me dosjen nr. 5, nga analiza e akteve nga ana e KLP-së ishte konstatuar se veprimet hetimore kishin nisur në datën 23.3.2015, datë në të cilën ishte regjistruar procedimi penal nr. ***. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se pavarësisht se kallëzimi figuron me datë 30.12.2014, regjistrimi i tij në organin e prokurorisë është bërë në datën 12.1.2015, dhe është marrë në dorëzim prej tij në datën 26.1.2015, ndërsa në datën 23.3.2015 është regjistruar procedimi penal. Më tej subjekti ka sqaruar se vonesa në regjistrimin e procedimit penal ka qenë e paqëllimshme dhe e justifikueshme për shkak të ngarkesës së madhe në punë. Nga kjo vonesë sipas subjektit nuk ka ardhur asnjë pasojë e tillë që të cenonte afatet e hetimit, apo të drejtat e palëve të procedimit penal dhe se personi i kallëzuar/i pandehuri është proceduar penalisht, hetuar, dërguar për gjykim dhe dënuar me vendim gjyqësor. Për të mbështetur pretendimet e tij subjekti ka paraqitur kopje të fashikullit të procedimit penal nr. *** viti 2015 dhe kopje të regjistrimit të njoftimit të kallëzimeve të veprave penale të prokurorisë të vitit 2015. Bazuar në dokumentet shkresore Komisioni i vlerësoi bindëse argumentet e subjektit dhe çmoi se vonesa që nga data 26.1.2015 kur subjekti e ka marrë kallëzimin në dorëzim, deri në datën 23.3.2015 të regjistrimit të procedimit penal, nuk ka cenuar afatet e hetimit. Për më tepër, nga aktet e fashikullit vërehet se i pandehuri është proceduar penalisht dhe është dërguar për gjykim.

85. Nga verifikimi i të dhënave arkivore rezultoi se për subjektin Enklid Gjini: (i) nuk ka masa disiplinore, kallëzime apo procedime penale; (ii) nuk ka të dhëna apo informacione për cenim të figurës, që ai të jetë përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, si dhe të dhëna për raste të identifikimit të subjektit të rivlerësimit për kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtar të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale), ku përfshihen edhe biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike; (iii) subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “shumë mirë”, për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016 nga Prokurori i Përgjithshëm; (iv) katër praktikë-ankesa të trajtuara nga Prokuroria e Përgjithshme, dy nga të cilat ishin adresuar edhe pranë Komisionit, ndërsa për dy të tjerat nuk u vlerësua e nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme.

86. Nga informacioni i marrë në rrugë publike, janë administruar shtatë denoncime dhe një informacion i publikuar në mediat *online*, për të cilat u kryen verifikimet si vijojnë.

87. Në denoncimin e tij, shtetasi Z. Gj. ngrinte pretendime në lidhje me prokurorin Enklid Gjini duke referuar dy raste të trajtuara nga subjekti, kur ai ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Fier, si vijojnë:

i) Rastin që lidhet me rrëmbimin dhe dhunimin e një vajze të re në qytetin e Fierit nga një magjistrat, të demaskuar publikisht në emisionin “****” të datës 19.10.2021, për të cilën subjekti ka vendosur mbylljen e çështjes pa kryer hetime të plota, pa u njoftuar e dhunuara për mbylljen e hetimeve dhe duke u zgjatur pa shkak afati i hetimeve.

ii) Rastin që lidhet me personin që goditi me grusht ish-kryeministrin S. B., i cili është marrë i pandehur nga subjekti në vitin 2017 duke u dënuar vetëm me 200.000 lekë ndërkohë që dëmi

ndaj të dëmtuarit ka qenë shumë i rëndë, të trajtuar nga gazetari S. K. në TV *** ***. Për të mbështetur pretendimet tij denoncuesi ka paraqitur një CD.

87.1. Gjatë hetimit administrativ, me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit, për rastin e parë Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dosjen e procedimit penal nr. ***, viti 2013, nga aktet e së cilës u verifikuan të gjitha veprimet hetimore të kryera dhe në përfundim të hetimit rezultoi se:

- Sa i takon pretendimit mbi mosnjohimin e së dëmtuarës, u konstatua se me shkresën nr. *** prot., datë 12.11.2013, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i është dërguar shtetases G. N. vendimi i pushimit të procedimit penal. Me njohimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë pretendim. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se prej tij është përpiluar shkresa për njohimin e kallëzueses G. N., duke shënuar adresën që vetë kjo shtetase ka deklaruar në organin procedues, deklaruar edhe nga të afërmit e saj. Sipas tij, është sekretaria ajo që ndjek më pas procedurën administrative të njohimeve, e cila e ka dërguar njohimin në adresën e dhënë nëpërmjet shërbimit postar. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur kopje të vendimit të pushimit, shoqëruar me shkresën e njohimit nr. *** prot., datë 12.11.2013 dhe kopje të regjistrit të korrespondencës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Pra, nga sa konstatohet, nga ana e subjektit si prokuror i çështjes janë zbatuar rregullat e njohimit, duke u dërguar vendimi i pushimit në adresën e deklaruar prej kallëzueses.

- Sa i takon pretendimit për moskryerje hetimesh të plota, nga aktet e dosjes u konstatua se një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi nga ana e subjektit janë kryer veprime hetimore, pavarësisht faktit se shtetasja G. N. ka deklaruar se ka hequr dorë nga çdo lloj ankimi.

- Sa i takon pretendimit për zgjatjen e afatit të hetimeve pa shkak, nga përmbajtja e vendimit për zgjatjen e afatit të hetimeve dhe akteve në dosje konstatohet se ky hetim është zgjatur me arsyetimin se *“për çështjen janë kryer veprime hetimore, por nuk është bërë i mundur përfundimi i tyre”*, ndërkohë që pas këtij vendimi rezultoi të jetë kryer vetëm një veprim hetimor, që është pyetja e babait të kallëzueses G. N. (në deklarimin e tij, ky shtetas ka deklaruar se marrëdhëniet mes tyre janë normalizuar dhe nuk kanë më konflikte). Në përfundim të hetimit administrativ, konstatohet se zgjatja e këtij afati nuk duket të jetë tërësisht e justifikuar sipas parashikimeve të nenit 324/2 të Kodit të Procedurës Penale. Me njohimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim. Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se për këtë procedim është bërë vetëm një zgjatje e afatit të hetimit dhe kjo për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe se nuk ka pasur zvarritje të hetimeve. Në analizë të sqarimeve të subjektit dhe në një analizë të të gjitha veprimeve të kryera nga subjekti në kuadër të hetimit të kësaj çështjeje, për të cilat nuk u konstatuan mangësi, vlerësohet se zgjatja e hetimeve nuk ka shkaktuar vonesa dhe nuk cenon aftësitë e subjektit për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore.

87.2. Sa i takon rastit që lidhet me personin që goditi me grusht ish-kryeministrin S. B., nga verifikimi i informacioneve të publikuara në media⁶⁹ në [link-un https://boldnews.al***](https://boldnews.al***), rezultoi se në vitin 2017 prokurori Enklid Gjini ka regjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2017 ndaj të pandehurit G. Sh., ku në përfundim të hetimeve ka kërkuar dënimin e tij për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje” duke kërkuar dënimin e tij me gjobë. Vendimi i prokurorit është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ky shtetas është dënuar me 200.000 lekë gjobë. Nga përmbajtja e vendimit të gjykatës vërehet se gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar e analizuar edhe mbi llojin dhe masën e dënimit të kërkuar nga prokuroria dhe e ka gjetur atë të drejtë. Në këto kushte, sa i takon vlerësimit të pretendimit të denoncuesit mbi masën e dënimit të kërkuar, një vlerësim i tillë del jashtë tagrit

⁶⁹ Në pamundësi për të aksesuar CD-në e depozituar nga denoncuesi, u verifikua *link-u online*.

të Komisionit, duke qenë se pretendime të tilla i nënshtrohen vetëm shqyrtimit gjyqësor, sikurse ka ndodhur në rastin konkret.

88. Denoncuesi H. Sh.⁷⁰ denoncon prokurorin Enklid Gjini dhe OPGJ N. N., të cilët sipas tij ende nuk kanë zbardhur çështjen e kallëzuar prej tij. Nga përmbajtja e denoncimit rezultoi se kallëzuesi në datën 21.7.2018 ka bërë një kallëzim penal ndaj shtetasve K. Sh., D. Sh. dhe Z. Sh., të cilët kanë pushtuar tokën në pronësi të tij, për të cilën është i pajisur me certifikatë pronësie. Sipas tij, kanë kaluar më shumë se 6 muaj dhe çështja ende nuk ka marrë zgjidhje dhe se, pavarësisht se ai ka bërë kallëzim për veprën penale “pushtim i tokës”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal ndaj tre shtetasve K., D. dhe Z. Sh., çështja është regjistruar pa autor. Denoncuesi ka paraqitur bashkëngjitur denoncimit dokumentacionin e pronësisë së tij.

88.1. Gjatë hetimit administrativ, me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit, Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dosjen e procedimit penal nr. ***, viti 2015, nga aktet e së cilës u verifikuan të gjitha veprimet hetimore të subjektit, nga ku rezultoi se subjekti në vitin 2015 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “shkatërrim i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal⁷¹, në ngarkim të shtetasit K. Sh., mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit H. Sh. për veprën penale “shkatërrim i pronës” ndaj shtetasve K. Sh. dhe D. Sh., ndërsa në datën 20.6.2016 ka vendosur të marrë si të pandehur shtetasin D. Sh., duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale “vetëgjyqësi⁷²”. Në datën 23.6.2016 ka dërguar për gjykim procedimin penal nr. *** të vitit 2015 në ngarkim të tij; Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka pushuar çështjen.

88.2. Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, ku subjektit i kaloi barra e provës, duket se:

- i) në përfundim të hetimeve paraprake subjekti nuk ka proceduar me pushimin e akuzës/apo dërgimin për gjykim të shtetasit K. Sh. sipas parashikimeve të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale⁷³, në ngarkim të të cilit kishte regjistruar procedimin penal për veprën penale “shkatërrimi i pronës” parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal;
- ii) në mënyrë të paqartë dhe të argumentuar, pavarësisht kallëzimit penal të shtetasit H. Sh. për veprën penale “shkatërrim i pronës” për të dy shtetasit K. Sh. dhe D. Sh., subjekti ka regjistruar procedimin penal vetëm për shtetasin K. Sh., ndërkohë që shtetasi D. Sh. është marrë më vonë si i pandehur dhe vetëm ai është dërguar për gjykim për veprën penale “vetëgjyqësi”, duke ndryshuar në këtë mënyrë dhe cilësimin juridik të veprës penale për të cilën ishte kallëzuar ky shtetas dhe duke i paraprirë amnistisë që pritej të miratohej, ndërkohë që vepra penale “shkatërrim i pronës” nuk ishte e përfshirë në veprat penale që amnistoheshin;
- iii) në dosje nuk rezultojnë të dokumentuara përgjigjet e organit procedues për kërkesat e palëve sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale;
- iv) në dosje nuk ka vendime për zgjatjen e afatit të hetimeve, sipas parashikimit të nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se afati tremujor sipas parashikimit të nenit 323/1 të Kodit të Procedurës Penale ka kaluar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

89. Pas njohjes me rezultatet e hetimit, në parashtrimet e tij subjekti ka sqaruar sa vijon:

⁷⁰ Shihni denoncimet nr. *** prot., datë 1.3.2018 dhe nr. *** prot., datë 1.4.2019, në dosjen e Komisionit.

⁷¹ Neni 150 “Shkatërrimi i pronës” parashikon se: “Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës, kur pasojat materiale nuk janë të lehta, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”.

⁷² Neni 227 i Kodit Penal “Vetëgjyqësi” parashikon se: “Ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj”.

⁷³ 2. Prokurori, pasi shqyrton aktet dhe sigurohet që i pandehuri ose mbrojtësi është njohur me to, vendos, sipas rastit, pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykatë.

89.1. Së pari, në lidhje me konstatimin e parë se ai nuk ka proceduar me pushimin e akuzës apo dërgimin për gjykim të shtetasit K. Sh., për të cilin ishte regjistruar procedimi penal, subjekti ka deklaruar se procedimi penal me urdhrin e datës 23.7.2015 është regjistruar për veprën penale “shkatërrim i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, por pa autor, dhe se vendosja e emrit të shtetasit K. Sh. si person që i atribuohet vepra penale është një lapsus në redaktimin e aktit, fakt që sipas subjektit provohet dhe nga gjeneralitetet e këtij shtetasi, të cilat nuk rezultojnë të plota dhe të sakta, pasi në këtë urdher rezulton datëlindja ***, ndërkohë shtetasi K. Sh. është i datëlindjes 12.3.1942. Një tjetër fakt që mbështet pretendimin e tij, sipas subjektit është edhe fakti që emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale dhe kualifikimi ligjor i veprës penale në “vetëgjyqësi”, është saktësuar me urdhrin për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale të datës 6.5.2016, ku në këtë akt përcaktohet qartë që në krye të regjistrimit se në datën 23.7.2015 është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale “shkatërrim i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal (pa autor). Fakt tjetër sipas subjektit, që dëshmon se jemi përpara një gabimi njerëzor në shënimin e emrit të shtetasit K. Sh., është se në të gjitha aktet hetimore të kryera në vijim nuk rezulton asnjë fakt/veprim në ngarkim të shtetasit K. Sh., por vetëm kundrejt shtetasit D. Sh.

89.2. Në përfundim të procesit, Komisioni i vlerësoi të bazuara deklaratimet e subjektit dhe krijoi bindjen se regjistrimi i procedimit ka qenë pa autor, sikurse subjekti pretendon. Kjo referuar fakteve:

- Në akte të ndryshme të dosjes penale, gjeneralitetet e shtetasit K. Sh. janë të ndryshme, p.sh. në urdhrin për regjistrimin e procedimit penal viti i lindjes është ***, ndërsa në akte të tjera ai ka ditëlindjen 12.3.1942.

- Në urdhrin për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale e datës 6.5.2016, në hyrje të tij referohet fakti që në datën 23.7.2016 është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale “shkatërrim i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, pa u përcaktuar nëse është regjistruar me autor.

- Në të gjitha aktet hetimore të kryera, pjesë e dosjes nuk rezulton asnjë fakt/veprim hetimor në ngarkim të shtetasit K. Sh.

- Vetë denoncuesi në denoncimin e tij shprehet se lidhur me kallëzimin e tij çështja është regjistruar pa autor.

89.3. Së dyti, në lidhje me konstatimin mbi regjistrimin fillestar të veprës penale “shkatërrim i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, e më pas për veprën penale “vetëgjyqësi” parashikuar në nenin 277 të Kodit Penal, subjekti ka parashtruar se procedimi penal është regjistruar fillimisht për veprën penale “shkatërrim i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, pasi nga faktet e referuara në momentin e konstatimit të faktit penal është dyshuar se ka elemente të kësaj vepre. Në vijim, nga hetimi është konstatuar se ka elemente të veprës penale “vetëgjyqësi”, parashikuar në nenin 277 të Kodit Penal, duke u saktësuar kualifikimi ligjor i veprës penale. Më tej, subjekti ka analizuar elementet e veprës penale “vetëgjyqësi”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Sipas tij *veprimet e kryera nga ana e shtetasit D. Sh. janë veprime të cilat janë kryer në kuadër të një të drejte që ai pretendon se i përket në kuptim të nenit 277 të Kodit Penal dhe jo për shkatërrimin e pronës së kallëzuesit në kuptim të nenit 150 të Kodit Penal, pasi shtetasi D. Sh. korrjen e të mbjellave në pronën objekt konflikti e ka kryer si një veprim legjitim, duke pretenduar se është e drejta e tij, pasi pretendon se toka është në pronësi të tij, për rrjedhojë ai gëzon tagrin e posedimit. Konkretisht, nga procesverbali i deklaratimit datë 1.4.2016, shtetasi D. Sh. deklaroi se pronën objekt konflikti e punon dhe e shfrytëzon që prej vitit 1991 dhe se ka paguar edhe taksat lidhur me këtë pronë. Përcaktimi i faktit penal të lartpërmendur është sqaruar në vijim të hetimeve, ku i kallëzuari ka sqaruar situatën dhe ka paraqitur akte, duke pretenduar interesin e tij të ligjshëm në veprimin e ndërmarrë, si: procesverbali i deklaratimit datë 1.4.2016, procesverbal për marrjen e*

dokumentit datë 25.3.2016, shkresa nr. *** prot., shkresa nr. *** prot, shkresa nr. *** prot. e Njësisë Administrative ***, etj. (me qëllim saktësimin e pretendimeve të kallëzuesit dhe të të kallëzuarit, për rrjedhojë saktësimin e faktit penal. Subjekti i referohet në analizën e tij vendimit unifikues nr. 1, datë 25.3.2005, të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit, në kuptim të nenit 277 të Kodit Penal, autori i veprës në vetëgjyqësi synon të realizojë një të drejtë që i përket, apo sipas rrethanave pretendon se i përket atij, dhe është i bindur sipas këtyre rrethanave (edhe pse mund të mos ketë të drejtë) se ajo që pretendon se i përket atij është e drejtë. Më tej, subjekti ka deklaruar se ligji nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, është miratuar në datën 22.12.2016, është shpallur me Dekretin nr. 9927, datë 30.12.2016 dhe është publikuar në Fletoren Zyrtare në datën 30.12.2016 (nr. 255), ndërsa urdhri për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale “vetëgjyqësi” është bërë në datën 6.5.2016, pra rreth 7 muaj përpara se të miratohej ligji për amnistinë e, në këto kushte, për një kohë të gjatë ai nuk mund të kishte dijeni paraprakisht.

89.4. Në përfundim të procesit, për sa pretendohet nga subjekti lidhur me ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale, Komisioni, pa zëvendësuar interpretimin dhe logjikën e prokurorit, vëren se në parashtrimet e tij subjekti ka bërë një analizë të plotë të elementeve të dyja veprave penale “shkatërrim i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal dhe “vetëgjyqësi”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Nga ana tjetër, referuar nenit 372 të Kodit të Procedurës Penale, është në tagrin e prokurorit të procedojë me ndryshimin e akuzës dhe ngritjen e akuzës përkatëse, në rast se gjatë shqyrtimit gjyqësor fakti del ndryshe nga sa është përshkruar në kërkesën për gjykim. Përtej kësaj, duke mbajtur në konsideratë pikën 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: “...vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektesinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet...”, si dhe jurisprudencën e Kolegjit⁷⁴, çmohet se vlerësimi në lidhje me ndryshimin e kualifikimit ligjor nuk është i një natyre procedurale, por lidhet me themelin e çështjes dhe, si e tillë, është jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit. Për më tepër, pas dërgimit për gjykim të çështjes, gjykata nuk i ka dhënë veprës penale një kualifikim të ndryshëm nga ai i subjektit në cilësinë e prokurorit.

89.5. Së treti, lidhur me konstatimin se në dosje nuk ka vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve, subjekti deklaroi se nuk është tejkalluar afati 3-mujor sipas nenit 323/2 të Kodit të Procedurës Penale, pasi emri i shtetasit D. Sh. si person që i atribuohet vepra penale, është regjistruar në datën 6.5.2016 (ku gjatë kësaj kohe janë kryer një sërë veprimesh hetimore, pjesë e dosjes). Në datën 20.6.2016, këtij shtetasi i është komunikuar akuza, duke u marrë si i pandehur dhe në datën 23.6.2016 është dërguar për gjykim procedimi penal në ngarkim të tij. Pra, nga momenti i identifikimit të personit që i atribuohet vepra penale (datë 6.5.2016) deri në përfundimin e hetimeve, nuk kanë kaluar 3 muaj për të proceduar me zgjatjen e afatit të hetimeve sipas parashikimit të neneve 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale. Në vlerësimin përfundimtar u çmua se për sa kohë shënimi i emrit të shtetasit K. Sh. në urdhrin e regjistrimit të procedimit penal si person që i atribuohet vepra penale u konsiderua të ketë qenë një lapsus, pasi regjistrimi i veprës penale ka qenë pa autor, sikurse është arsyetuar më sipër, si dhe në kushtet kur afati i

⁷⁴ Vendim nr. 28, datë 23.10.2020, i Kolegjit për subjektin F. V., sipas të cilit: “Kolegji çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin e çmimin e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit. Në rastin konkret, pikërisht vlerësimi i aftësive profesionale të magjistratit, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupin gjykues përkatës, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit, prandaj edhe Kolegji vlerëson se konkluzioni se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar, duke deklaruar pafajësinë e njërit prej të gjykuarve, është një konkluzion në tejkallim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si e tillë, nuk mund të përdoret për të kryer vlerësimin e tij”.

hetimeve lidhet pikërisht me këtë moment, konstatimi mbi mungesën e një vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve nuk qëndron.

89.6. Së katërti, në lidhje me mungesat e përgjigjeve të organit procedues për kërkesat e palëve sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka parashtruar se kërkesat e kallëzuesit, konkretisht kërkesat nr. *** prot., datë 20.5.2016, si dhe nr. *** prot., datë 27.4.2016, kanë si objekt *njohjen me aktet e dosjes penale*. Ndërkohë, në referim të nenit 278 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se: *“Aktet hetimore janë sekrete derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to. Në rast nevojë për vazhdimin e hetimeve, prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit për veprime të veçanta deri në përfundim të hetimeve”*⁷⁵. Sipas subjektit, e drejta për t’u njohur me aktet e dosjes është kërkuar nga kallëzuesi para marrjes së cilësisë si i pandehur të shtetasit D. Sh., për rrjedhojë është vlerësuar ruajtja e sekretit hetimor. Ndërkohë, e drejta e viktimës për informim, parashikuar në nenin 279/a të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka qenë e parashikuar në legjislacionin procedural penal para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017⁷⁶. Ndërsa kërkesat e tjera janë vlerësuar si të pabazuara në ligj dhe në prova, pasi kallëzuesi ka kërkuar: *“Oficeri i policisë gjyqësore I. M. bëri shantazh duke më thënë se unë nuk kam mbjellë grurë, se kishte bërë hetime në datën 6.7.2015. Kërkojmë që hetimi i çështjes të mos kryhet nga z. G. Ç. dhe z. I. M., të cilët fshehin provat e krimit dhe hetimin nuk e bëjnë sipas ligjit”*. Për sa argumentuar si më lart, sipas subjektit kërkesat e bëra nga kallëzuesi nuk kanë qenë memorie apo kërkesa me shkrim, në kuptim të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale.

89.7. Për sa pretendohet nga subjekti në lidhje me mungesat e përgjigjeve të organit procedues për kërkesat e palëve sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, në analizë të sqarimeve të subjektit, Komisioni sjell në vëmendje përcaktimet e nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit: *“1. Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim. 2. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve”*. Sipas kësaj dispozite, organi procedues është i detyruar të shprehet me vendim për të gjitha kërkesat e palëve në procedim brenda një afati të caktuar, pa qenë i detyruar t’i pranojë ato kërkesa. Në rastin konkret, pavarësisht argumenteve të subjektit se mosmarrja e një vendimi sipas kësaj dispozite ligjore ka ardhur për shkak të nevojës së ruajtjes së sekretit hetimor apo vlerësimin si të pabazuara në ligj e prova të kërkesave të tjera, duke iu referuar nenit 278 të Kodit të Procedurës Penale, në përfundim Komisioni çmoi se subjekti duhet të shprehet me vendim, por nuk e konsideron këtë si një gabim thelbësor, serioz dhe të përsëritur, në mënyrë të tillë që të jetë kthyer në një model pune për subjektin e rivlerësimit dhe, për pasojë, problematika e evidentuar që i përket një rasti të vetëm, nuk i cenon aftësitë profesionale të subjektit në atë nivel që mund të bëhet shkak për penalizim të tij.

90. Në denoncimin e saj, shtetasja E. Gj.⁷⁷ pretendon se subjekti ka filluar hetime të paligjshme në rastin e shtetasës E. B. për veprën penale “shpërdorim detyre”; në kundërshtim me ligjin e ka zvarritur hetimin për tre vjet; ka kryer hetime të paligjshme pa vendim gjykate; ka dërguar për gjykim çështjen pa pasur prova dhe gjykata vendosi pushimin e çështjes. Së fundi, në kundërshtim me ligjin nuk ka bërë ankim kundër vendimit të gjykatës.

⁷⁵ Dispozita është cituar sipas ligjit procedural penal të kohës.

⁷⁶ Neni 279/a/1 i Kodit të Procedurës Penale, shtuar me ligjin nr. 35/2017, parashikon: *“Për shkaqe të ligjshme, viktima, përfaqësuesi ligjor ose mbrojtësi i saj kanë të drejtë të kërkojnë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihen dhe të marrin kopje të akteve dhe provave që ndodhen në fashikullin e prokurorit”*.

⁷⁷ Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 25.2.2021, nga shtetasja E. Gj., në dosjen e Komisionit.

90.1. Gjatë hetimit administrativ, me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncueses, u administrua nga Prokuroria e Rrethit Tiranë dosja e procedimit penal nr. ***, viti 2014⁷⁸, nga aktet e së cilës u verifikuan të gjitha veprimet hetimore, nga ku rezultoi se:

i) Në lidhje me pretendimin e denoncueses se subjekti ka filluar hetime të paligjshme në rastin e shtetases E. B. për veprën penale “shpërdorim detyre”, vlerësohet se nuk qëndron, pasi subjekti ka nisur hetimet mbi bazën e kallëzimit të subjektit “***” sh.a. Funksionet e prokurorit parashikohen në nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale, ndër të cilat janë ushtrimi i ndjekjes penale dhe ngritja e akuzës. Më tej, Kodi i Procedurës Penale në kreun II të tij parashikon rregullat për marrjen dijeni të veprës penale nga prokurori me iniciativën e tij ose me njoftimin e bërë nga të tjerët përmes kallëzimeve penale. Po sipas këtyre dispozitave prokurori shënon në regjistër çdo njoftim që i vjen për vepra penale, e po kështu, referuar nenit 304 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori drejton veprimtarinë hetimore dhe vendos kur plotësohen kriteret e procedimit sipas kreut III të Kodit të Procedurës Penale. Në çdo rast, pretendime të kësaj natyre janë objekt ankimi në gjykatë dhe zgjidhen përmes shqyrtimit gjyqësor.

ii) Për sa pretendohet që subjekti ka zvarritur çështjen për tre vjet, referuar nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, afati i hetimeve paraprake është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Kodi i Procedurës Penale i njej prokurorit të drejtën e zgjatjes së afatit të hetimeve për një kohë deri në tre muaj dhe zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t’i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Në rastin konkret, subjekti ka proceduar me pesë urdhra për zgjatje të afatit të hetimeve me nga tre muaj, nga përmbajtja e të cilëve vihet re se zgjatja e afatit ka ardhur nga nevoja e veprimeve të mëtejshme hetimore, por edhe pamundësisë për pyetjen e të pandehurës. Megjithatë, nga aktet e dosjes u konstatua se mungon urdhri për zgjatjen e afatit të hetimeve për periudhën 23.2.2015 – 23.5.2015, dhe në referim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, neni 324/4, veprimet hetimore të kryera pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se mungesa e njërit prej urdhrave (të ndërmjetëm në afatin kohor) lidhet vetëm me faktin e mosadministrimit të tij nga pakujdesia gjatë printimit dhe bërjes pjesë të dosjes dhe jo për qëllim për të mos vijuar me zgjatjen e afatit të hetimeve, pasi kjo është realizuar me urdhrin e mëpasshëm, duke pasqyruar të gjitha veprimet e kryera gjatë hetimit të kësaj çështjeje. Sipas subjektit, mungesa e këtij akti të ndërmjetëm nuk ka ndikuar dhe nuk ka sjellë pasojë pavlefshmërie apo papërdorshmërie të akteve të hetimeve paraprake. Avokatja dhe e pandehura janë njohur me të gjitha aktet në përfundim të hetimit dhe nuk kanë pasur asnjë pretendim, për këtë shkak as në këtë moment dhe as gjatë gjykimit. Më tej, subjekti ka sqaruar se vendimi i zgjatjes së afatit në fjalë është përpiluar prej tij dhe është nënshkruar në emër të Drejtuesit të Prokurorisë P. F., pasi në datën 15.2.2015 subjekti deklaroi se ka udhëtuar për një trajnim në ***, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga i cili është kthyer në datën 23.3.2015. Sipas subjektit, kjo zgjatje i është dërguar të pandehurës me shkresën nr. *** prot., datë 2.3.2015 dhe për shkak të volumit të dosjes mund të ketë ndodhur të mos jetë vendosur në fashikull gjatë fotokopjimit të saj. Subjekti ka deklaruar gjithashtu se sipas vendimit nr. ***, datë 9.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezultoi se gjykimi është kryer me procedurën e gjykimit të shkurtuar, pa u ngritur asnjë lloj pretendimi mbi pavlefshmëri apo papërdorshmëri aktesh dhe mungesa fizike e këtij akti nuk ka sjellë asnjë pasojë në zgjidhjen e çështjes. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur: (a) një kopje në formë të printuar të vendimit për zgjatje afati, dokument i cili edhe aktualisht ndodhet

⁷⁸ Shihni dosjen e procedimit penal nr. ***, viti 2014, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në dosjen e Komisionit.

në *folder*-in e dokumenteve të ruajtura nga ana e tij në kompjuterin e punës; (b) fotografim të këtij *folder*-i, ku rezulton si datë e krijimit të këtij dokumenti data 13.2.2016; (c) kopje të zgjatjeve të afatit të hetimeve të procedimit penal, si dhe shkresat për dërgimin e tyre të pandehurës; (ç) kopje të vendimit nr. ***, datë 9.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në analizë të parashtrimeve, sa i takon dokumentit të paraqitur nga subjekti, urdhrin për zgjatje hetimesh, i panënshkruar, Komisioni vlerëson se ai nuk përbën një akt zyrtar të përpiluar në formën e kërkuar nga ligji sipas neneve 246, 251, 253 dhe 254 të Kodit të Procedurës Civile. Nga ana tjetër, nga verifikimi në sistemin TIMS vërtetohet pretendimi i subjektit se nga data 15.2.2015 deri në datën 23.3.2015 ai ndodhej jashtë vendit, në SHBA, çka vërteton faktin që në momentin që duhej të hartohej urdhri për shtyrjen e afatit të hetimeve në datën 23.2.2015, ai nuk ishte duke ushtruar detyrën. Pavarësisht kësaj, Komisioni vlerëson se subjekti mund të kishte marra masa dhe të delegonte të gjitha veprimet që duhet të kryheshin lidhur me dosjen. Megjithatë, në vlerësimin përfundimtar të çështjes, në kushtet kur çështja i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, nga ku nuk kanë rezultuar problematika procedurale, si dhe nuk kanë ardhur pasoja rënduese për palën, mungesa e dokumentuar zyrtarisht e urdhrin për shtyrjen e hetimeve nuk vlerësohet si mangësi procedurale me pasojë për subjektin.

iii) Në lidhje me pretendimin se subjekti ka kryer hetime të paligjshme pa vendim gjykate, pavarësisht se denoncuesja nuk e përcakton veprimin hetimor konkret për të cilin nevojitej vendim gjykate, nga aktet në dosje dhe referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, nuk rezultojnë të jenë kryer veprime hetimore për të cilat ka qenë i nevojshëm autorizimi i gjykatës. Sa i takon këqyrjes së sendeve, referuar nenit 198 të Kodit të Procedurës Penale, kryerja e këtij veprimi hetimor vendoset nga organi procedues, ndërsa sa i takon sekuestrimit të provave materiale, referuar nenit 208 të Kodit të Procedurës Penale, mund të vendoset si nga prokurori, ashtu edhe nga gjyqtari.

iv) Sa i takon pretendimit se subjekti ka dërguar për gjykim çështjen pa pasur prova dhe gjykata vendosi pushimin e çështjes, nga aktet në dosjen penale vihet re se kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2015, përmbush elementet e që duhet të përmbajë kërkesa për gjykim, përfshirë dhe burimet e provës (listohen provat), sikurse parashikohet në nenin 331/2 të Kodit të Procedurës Penale.

v) Në lidhje me pretendimin e fundit të denoncueses se subjekti në kundërshtim me ligjin nuk ka bërë ankim kundër vendimit të gjykatës, nga verifikimi i akteve të dosjes nuk gjendet vendimi i gjykatës dhe as ankimi i prokurorit të çështjes. Në nenin 329/3 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim nga prokurori i çështjes. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të informojë lidhur me faktin nëse subjekti ka ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës e, nëse po, të paraqesë ankimin e, nëse jo, të japë sqarime lidhur me mosushtrimin e ankimit. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se nga ana e tij si prokuror i çështjes, pas vendimit të Gjykatës, është përpiluar ankim në datën 17.6.2016 (brenda afatit ligjor) së bashku me shkresën përkatëse, i cili sipas rregullave është lënë në zyrën e Drejtuesit të Prokurorisë për nënshkrim nga ana e tij. Gjithashtu, ai ka sqaruar se çdo shkresë apo akt procedural nënshkruhej nga titullari dhe vetëm me shkresë përcjellëse të nënshkruar prej tij mund të dilte nga zyra e protokollit të Prokurorisë. Më tej, subjekti ka informuar se në dijeninë e tij ankimi nuk është nënshkruar nga titullari dhe se kjo është arsyeja që ankimi nuk ka shkuar as në Gjykatë dhe as për dijeni Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur: (a) kopje në formë të printuar të Apelit, datë 17.6.2016, kundër vendimit në fjalë; (b) fotografimi i *folder*-it, ku rezulton si datë e krijimit të këtij dokumenti data 17.6.2016.

90.2. Në përfundim, Komisioni vlerëson se pavarësisht se deklarimet e subjektit mund të jenë të vërteta nisur nga data e krijimit të dokumentit të printuar që ai paraqiti, nuk provohet

zyrtarisht fakti që të jetë ushtruar ankimi ndaj vendimit të pushimit të çështjes nga gjykata. Gjithsesi, nga përmbajtja e nenit 408 të Kodit të Procedurës Penale, duket se ushtrimi i të drejtës së ankimit është një tagër që i lihet vlerësimit të prokurorit.

91. Në një informacion të publikuar në media⁷⁹ ngriheshin pretendime se prokurori i Tiranës Enklid Gjini kishte ndryshuar akuzën ndaj shtetasit F. M., i arrestuar në muajin janar 2023 për “prodhim dhe mbajtje të armëve në bashkëpunim”, duke e akuzuar atë vetëm për “armëmbajtje pa leje” dhe se së bashku me gjyqtaren M. L. ka lehtësuar pozicionin e tij, duke zëvendësuar masën e sigurimit nga “arrest me burg” në “arrest shtëpie”.

91.1. Me qëllim verifikimin e pretendimeve të ngritura, Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë⁸⁰ fashikullin penal nr. ***, viti 2022, me autor të regjistruar shtetasin F. M., dërguar për gjykim në datën 30.12.2022 dhe fashikullin e masës së sigurimit⁸¹, nga aktet e të cilit në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

- Në lidhje me akuzën e ngritur, vihet re se që në urdhrin e regjistrimit të procedimit penal të datës 3.10.2022 prokurori Enklid Gjini ka regjistruar procedimin penal ndaj shtetasit F. M. për veprën penale “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 278/4 dhe 25 të Kodit Penal dhe kjo akuzë i është njoftuar në datën 13.12.2022 edhe shtetasit F. M., i cili është dërguar për gjykim në datën 21.12.2022 për të njëjtën akuzë. Pra, nuk vihet re ndryshim i akuzës.

- Në lidhje me ndryshimin e masës së sigurimit, nga aktet vihet re se zëvendësimi i masës së sigurimit është kërkuar nga avokati i shtetasit F. M. dhe gjykata ka pranuar zëvendësimin e saj nga “arrest me burg” në “arrest shtëpie”.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e kërkesës së avokatit të shtetasit F. M., i cili ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga “arrest me burg” në atë të “detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, me vendimin nr. ***, datë 28.12.2022, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesës dhe zëvendësimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, të dhënë me vendimin nr. ***, datë 11.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me masën e sigurimit personal “arrest në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale. Nga përmbajtja e vendimit, referuar pretendimeve të palëve në proces, prokurori ka kërkuar “Rrëzimin e kërkesës”. Po nga përmbajtja e vendimit vihet re se prokurori në seancën e datës 17.12.2022 ka sqaruar: *“Rrethanat aktuale janë të ndryshuara dhe rezultojnë zbutje e rrethanave mbi të cilat është caktuar masa në fuqi, me vendimin e gjykatës, pasi aktualisht akuzat penale ka ndryshuar nga ajo e parashikuar nga neni 278/1 – 25 e Kodit Penal, në atë të parashikuar në nenin 278/4 të Kodit Penal”*.

91.2. Në përfundim të hetimit administrativ ishte i paqartë ky qëndrim i subjektit. Gjithashtu, nuk duket të jetë ushtruar ankimi ndaj vendimit të gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurimit. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime bazuar në dokumente shkresore në lidhje me këto konstatime.

91.3. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se shtetasi F. M. është ndaluar duke i regjistruar emrin si person që i atribuohet vepra penale “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 278/4 dhe 25 të Kodit Penal, pasi është dyshuar se kjo veprë penale është kryer në bashkëpunim me shtetasin K. Gj. (në banesën e të cilit u gjet jo vetëm arma e lartpërmendur, por edhe një sërë armësh e municionesh të tjera).

⁷⁹ Në link-un <https://www.vizionplus.tv>**

⁸⁰ Shihni fashikullin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.5.2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁸¹ Shihni fashikullin e zëvendësimit të masës së sigurimit, bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.6.2023, nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në dosjen e Komisionit.

Sipas subjektit, në momentin e paraqitjes së kërkesës për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, datë 10.10.2022, ndaj shtetasit F. M., nuk ka qenë ende e qartë nëse elementi i bashkëpunimit midis tij dhe K. Gj. për veprën penale, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, lidhej vetëm me armën e gjetur në banesën e shtetasit K. Gj., në të cilën u identifikua gjurma papilare e shtetasit F. M. apo dhe ndaj armëve e municioneve të tjera të gjetura në këtë banesë. Më tej, subjekti ka sqaruar se në vijim të hetimeve, u qartësua ky dyshim dhe nuk u arrit të provohej se bashkëpunimi ekzistonte për të gjitha armët e sekuestruara në banesën e të pandehurit tjetër.

91.4. Sipas subjektit, deklarimi i tij në seancën gjyqësore të zhvilluar për zëvendësimin e masës së sigurimit datë 17.12.2022 (kërkuar nga mbrojtja e të pandehurit F. M. rreth dy muaj më pas) se rezultoi zbutje e rrethanave mbi të cilat është caktuar masa në fuqi (ajo e arrestit në burg), i referohet faktit se tashmë, në vijim të hetimeve të kryera dhe të përfunduara, rezultoi e provuar se elementi i bashkëpunimit i shtetasit F. M. me shtetasin K. Gj. lidhet vetëm për një armë (ajo e identifikuar nga akti i ekspertimit daktiloskopik) dhe jo për të tjerat të gjetura në banesën e këtij të fundit. Subjekti thekson se një fakt i tillë i është bërë prezent gjykatës me qëllim individualizimin e faktit penal, rëndësisë së tij dhe vlerësimit prej saj në vijim të nevojave të sigurimit ndaj këtij shtetasi. Subjekti gjithashtu ka saktësuar se vepra penale në ngarkim të të pandehurit F. M. është po e njëjta, ajo e parashikuar në nenet 278/4 dhe 25 të Kodit Penal, për të cilën mbas seancës së zëvendësimit të masës, në datën 21.12.2022 është proceduar me dërgimin për gjykim të të pandehurit. Po kështu, subjekti thekson se kërkesa për zëvendësim nuk është iniciuar nga ana e Prokurorisë, por nga mbrojtësi i të pandehurit dhe nuk ka qenë qëllim favorizimi i të pandehurit për zbutjen e masës. Për më tepër, në më pak se një javë, nga ana e tij është vendosur dërgimi i të pandehurit për gjykim, duke mos lënë mundësi që ai të përfitonte nga kjo masë siguri në llogaritjen e saj si masë dënimi më vonë.

91.5. Sa i takon faktit nëse është ushtruar ankimi ndaj vendimit të gjykatës për zëvendësimin e masës, subjekti deklaroi se prej tij nuk është vlerësuar ushtrimi i ankimit ndaj zëvendësimit të masës së sigurimit, pasi: (i) në momentin e shqyrtimit të kësaj kërkesë shtetasi F. M. akuzohej vetëm për një veprë penale, ajo e parashikuar nga neni 278/4 dhe 25 i Kodit Penal, e cila parashikon dënim relativisht të ulët (burgim nga 1 – 3 vjet) (dhe vetëm e kryer për një armë), në ndryshim nga dyshimi që ekzistonte fillimisht si bashkëpunëtor në mbajtjen e të gjitha armëve, për të cilën u caktua masa e sigurimit “arrest në burg”; (ii) gjendja e provave ishte e tillë për të përligjur mosushtrimin e ankimit (mbajtur në konsideratë edhe fakti se prova e vetme ku mbështetej akuzat ndaj tij ishte vetëm një gjurmë gishti dhe asnjë provë tjetër), çka reflektohet sipas subjektit edhe në vendimin e pafajësisë së dhënë nga Gjykata. Me vendimin nr. ***, datë 30.5.2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vendosur deklarin të pafajshëm të të pandehurit F. M. për veprën penale “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 278/4 e 25 të Kodit Penal.

91.6. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur: (i) urdhër për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, datë 3.10.2022; (ii) vendim për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës, datë 12.12.2022; (iii) vendim nr. ***, datë 30.5.2023, sipas të cilit shtetasi F. M. është shpallur i pafajshëm.

91.7. Pasi u shqyrtuan deklarinmet dhe provat që subjekti paraqiti, në përfundim të procesit Komisionit i rezultoi se përkundër sa pretendohet në denoncim, vepra penale për të cilën ishte regjistruar procedimi penal në ngarkim të shtetasit F. M., “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 278/4 dhe 25 të Kodit Penal, ishte e njëjta për të cilën ai u dërgua për gjykim, e po për këtë veprë ai u deklarua i pafajshëm nga gjykata. Për më tepër, në seancën gjyqësore subjekti Gjini është shprehur kundër ndryshimit të masës së sigurimit “arrest me burg”. Është e vërtetë se ndaj vendimit të gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurimit nuk është ushtruar ankimi nga ana e subjektit. Por, neni

249 i Kodit të Procedurës Penale parashikon ankimin kundër masave të sigurimit si një e drejtë që i takon prokurorit ta vlerësojë nëse mund ta bëjë. Për më tepër, duke parë ecurinë e çështjes, në kushtet kur shtetasi F. M. u deklarua i pafajshëm nga gjykata, Komisioni nuk mund të konkludojë për një mangësi procedurale me pasojë për shkak të mosushtrimit të ankimit nga ana e subjektit.

91.8. Përveç sa më sipër, pas kërkesës së Komisionit, ILD-ja⁸² ka informuar se nuk ka asnjë hetim apo procedim disiplinor të filluar ndaj subjektit Enklid Gjini në lidhje me këtë çështje.

92. Bazuar në informacionin e marrë pas vizitës në agjencitë ligjzbatuese, Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dosjen e procedimit penal nr. ***, viti 2015, që i përket shtetasit I. Sh.⁸³, nga aktet e së cilës rezultoi se:

- Në datën 1.9.2015, Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë materialet procedurale për arrestin e shtetasit I. Sh.. Nga këto materiale rezulton se ky shtetas duke udhëtuar me automjet, në fshatin *** ka aksidentuar këmbësoren Z. D., e cila u dërgua në gjendje të rëndë shëndetësore në Spitalin Ushtarak, dhe materialet i kaluan për ndjekje të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në ngarkim të shtetasit Indrit Shkupi, për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal. Me vendimin e datës 31.8.2015, OPGJ i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë ka vendosur kryerjen e ekspertimit autoteknik dhe ekspertimin mjekoligjor të shtetasës Z. D.

- Me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal të datës 1.9.2015, prokurori Enklid Gjini ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2⁸⁴ i Kodit Penal dhe regjistrimin e emrit të shtetasit Indrit Shkupi si person që i atribuohet vepra penale. Pas kërkesës së subjektit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 3.9.2015, vendosi të vleftësojë të ligjshëm arrestin në flagrancë të shtetasit I. Sh.

- Sipas aktit të ekspertimit autoteknik të datës 4.9.2015, të ekspertit L. Gj., në konkluzion shkaku kryesor i ndodhjes së aksidentit janë shkeljet e kryera nga drejtuesi i automjetit, konkretisht: mosrespektimi i kërkesave të neneve 139 dhe 146 të hyrjes me shpejtësi në kthesë, humbjes së kontrollit të drejtimit të mjetit, si dhe tentativës për të hyrë në parakalim pa u siguruar se ky veprim paraqet rrezik për përdoruesit e tjerë të rrugës. Ndërkohë që nuk ka pasur shkelje të normave të Kodit Rrugor nga ana e shtetasës Z. D..

- Sipas aktdëshmisë mjekoligjore nr. *** të datës 4.9.2015, arrihet në konkluzionin se dëmtimet e shtetasës Z. D. hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve që kanë sjellë për pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën mbi 9 ditë pushim.

- Me vendimin e datës 22.9.2022, prokurori Enklid Gjini ka vendosur pushimin e hetimeve në procedimin penal nr. *** të vitit 2015 dhe shuarjen e masës së sigurimit të dhënë me vendimin nr. ***, datë 3.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shtetasin I. Sh., duke arsyetuar se “...megjithëse nga ana e shtetasit I. Sh. janë shkelur dispozitat e Kodit Rrugor, nuk ndodhemi para veprës penale të “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal. Kjo pasi vepra penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, kërkon si element të domosdoshëm të saj minimalisht plagosjen e lehtë të disa personave, gjë që në rastin konkret

⁸² Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.5.2023, nga ILD-ja, në dosjen e Komisionit.

⁸³ Shihni dosjen bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr.*** prot., datë 1.6.2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁸⁴ “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e rëndë të një personi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”.

nuk ka ndodhur. Në këto kushte, nuk ekziston një nga elementet kryesore të kësaj dispozite që është pasoja e ardhur...". Nuk ka informacion nëse ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim dhe cila ka qenë vendimmarrja e gjykatës.

- Në konkluzion të analizës së këtij procedimi penal, vihet re se në vendimin për pushimin e procedimit penal subjekti ka arsyetuar vetëm lidhur me mungesën e elementeve të veprës penale "shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, veprë e cila kërkon si pasojë plagosjen e lehtë të disa shtetasve, ndërkohë që ka regjistruar procedimin penal për veprën penale "shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, e cila kërkon si pasojë plagosjen e rëndë të një personi, sikurse ka ndodhur në rastin konkret.

92.1. Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, ku subjektit i kaloi barra e provës, duket se:

- Vendimi i pushimit të procedimit penal të datës 22.9.2015 është në kundërshtim me provat e administruara gjatë hetimit, pasi nga akti i ekspertimit autoteknik u provua shkelja e rregullave të Kodit Rrugor nga ana e personit që i atribuohet vepra penale, ndërsa nga aktdëshmia mjekoligjore u provua pasoja e ardhur, që është plagosja e rëndë.

- Arsyetimi i subjektit në vendimin e pushimit duket se është i paqartë, pasi përkundër sa arsyetohet në urdhrin e regjistrimit të procedimit penal për veprën penale "shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal ndaj personit që i atribuohet vepra penale, në vendimin e pushimit ai arsyeton mbi mungesën e veprës penale të parashikuar nga neni 290/1, e cila kërkon si pasojë plagosjen e lehtë të disa personave.

92.2. Përveç sa më sipër, subjektit iu kërkuar të informojë nëse ndaj këtij vendimi është paraqitur ankim e, nëse po, të paraqesë vendimmarrjen e gjykatës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

93. Në parashtrimet e tij, subjekti ka kundërshtuar konstatimet e Komisionit, duke sqaruar se termat "plagosje e lehtë" dhe "plagosje e rëndë" përcaktohen në nenet respektive të Kodit Penal, kreu II, seksioni I, Krime kundër jetës të kryera me dashje (nenet 89 dhe 88 të Kodit Penal)⁸⁵. Këto përcaktime shërbejnë si kriter në të gjitha rastet kur në Kodin Penal përmenden termat plagosje e lehtë/plagosje e rëndë. Sipas tij, në rastin konkret, akti i ekspertimit mjekoligjor nr. ***, datë 4.9.2015, ka arritur në konkluzionin se tek e dëmtuara Z. D. janë shkaktuar dëmtime të cilat kanë sjellë për pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën mbi 9 ditë, në zbatim të legjislacionit penal të lartpërmendur, dhe se pasoja e ardhur si rezultat i shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor nga shtetasi I. Sh. është plagosje e lehtë dhe jo plagosje e rëndë.

93.1. Më tej, subjekti ka sqaruar se procedimi penal është regjistruar fillimisht për veprën penale "shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, pasi nga faktet e referuara në momentin e regjistrimit është dyshuar se shtetases Z. D., si rezultat i shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor nga shtetasi I. Sh., i është shkaktuar pasoja plagosje e rëndë. Në informacionin për referimin e veprës penale datë 31.8.2015, hartuar nga oficeri i Policisë Gjyqësore që ka kryer veprimet e para procedurale, ndër të tjera referohet se: "*Automjeti është aksidentuar me këmbësoren, shtetasen Z. D., e cila ndodhet në Spitalin*

⁸⁵ Neni 89 i Kodit Penal - Plagosja e lehtë me dashje: "*Plagosja e kryer me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet [...]*".

Neni 88 i Kodit Penal - Plagosja e rëndë me dashje: "*Plagosja e kryer me dashje që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, ndërprerjen e shtatzënisë, ose ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të saj, dënohet [...]*".

Ushtarak në gjendje të rëndë shëndetësore; Shtetasja Z. D. nuk është në gjendje të japë deklaram, pasi ndodhet në Spitalin Ushtarak në gjendje të rëndë [...]”.

93.2. Sipas subjektit, në kuptim të nenit 290 të Kodit Penal, vepra penale kryhet nëpërmjet shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor dhe vjen si pasojë: (i) plagosja e lehtë e disa personave (neni 290/1); (ii) plagosja e rëndë e një personi (neni 290/2); (iii) vdekja e një personi (neni 290/3); (iv) vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave. Pra, vepra penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar në nenin 290 të Kodit Penal, përbën një veprë penale materiale, e cila për efekt të cilësimit ligjor të veprës penale kërkon domosdoshmërisht ardhjen e pasojave, në të kundërt shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor përbën kundërvajtje administrative.

93.3. Në këto kushte, sipas subjektit, në vendimin e pushimit të procedimit penal nr. ***, viti 2015, është analizuar mungesa e ardhjes së pasojave të kërkuara nga neni 290 i Kodit Penal dhe është arritur në konkluzionin se nuk ka ardhur ndonjë nga pasojat e kërkuara nga kjo dispozitë, pasi nga akti i ekspertimit mjekoligjor nr. ***, datë 4.9.2015, është konkluduar se shtetas Z. D. i është shkaktuar plagosje e lehtë (jo plagosje e rëndë), pasojë e cila lidhur me cilësimin ligjor të faktit penal të referon në nenin 290/1 të Kodit Penal, ku parashikohet plagosje e lehtë. Subjekti vijon se kjo dispozitë për lindjen e përgjegjësisë penale kërkon detyrimisht shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë plagosjen e lehtë të disa personave⁸⁶.

93.4. Në konkluzion, subjekti parashtron se në kushtet kur nga hetimi u provua se pasoja e ardhur nga aksidenti nuk ishte plagosje e rëndë e shtetas Z. D., por plagosje e lehtë dhe vetëm e saj (jo plagosje e lehtë e disa personave), është disponuar me pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, pasi nuk ekziston pasoja kriminale si një nga elementet e domosdoshëm të anës objektive të veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal. Sipas tij, pavarësisht disponimit në vendimin e pushimit për paragrafin I apo II të nenit 290 të Kodit Penal, vendimi i pushimit është i drejtë dhe i bazuar në nenin 328 të Kodit të Procedurës Penale, pasi fakti i ndodhur nuk parashikohet nga ligji si veprë penale në asnjë nga paragrafët e nenit 290 të Kodit Penal. Po kështu, subjekti ka informuar se ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. *** nuk rezulton të jetë ushtruar ankim.

93.5. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur: (i) shkresën nr. ***, datë 27.6.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila konfirmon se ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. *** nuk rezulton të jetë ushtruar ankim nga shtetasit Z. D. apo I. Sh.; (ii) kopje të dosjes së procedimit penal nr. ***.

93.6. Në vlerësim të parashtrimeve të paraqitura dhe akteve shkresore të administruara, duket se subjekti në momentin e regjistrimit të procedimit penal i është referuar informacionit mbi referimin e veprës penale të datës 31.8.2015, të OPGJ O. Gj., sipas të cilit: “*Shtetasja Z. D. nuk është në gjendje të japë deklaram, pasi ndodhet në Spitalin Ushtarak në gjendje të rëndë*”. Bazuar në këtë informacion, ai ka bërë regjistrimin e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, me pasojë plagosjen e rëndë të një personi. Ndërsa në vendimin e pushimit të datës 22.9.2015 i është referuar aktëdhëmisë mjekoligjore nr. ***, datë 4.9.2015, sipas së cilës shtetas Z. D. i është shkaktuar plagosje e lehtë, duke arsyetuar mbi mungesën e veprës penale së parashikuar nga neni 290/1, e cila kërkon si pasojë plagosjen e lehtë të disa personave. Në përfundim të procesit, Komisioni çmon se pavarësisht se subjekti duhet të kishte treguar më shumë kujdes në drejtim të arsyetimit të mungesës së elementeve të veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, ashtu sikurse ka arsyetuar në parashtrimet e veta, subjekti kundërshtoi barrën e provës sa i takon vendimmarrjes së pushimit të hetimeve, duke

⁸⁶ Neni 290, paragrafi I parashikon: “*Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet me jobë ose me burgim deri në një vit*”.

mirargumentuar shkaqet që e çuan në këtë vendimmarrje. Për më tepër, nga shtetasja Z. D. nuk është ushtruar ankim.

94. Me qëllim verifikimin e një informacioni tjetër të marrë pas vizitës në agjencitë ligjzbatuese në lidhje me një çështje që i përket shtetasit S. L., Komisioni administroi të dhëna nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë⁸⁷, nga ku rezultoi se procedimi penal që ka lidhje me këtë shtetas nuk është trajtuar nga subjekti i rivlerësimit.

95. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale sipas kriterëve të parashikuara në nenet 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe pikën 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, është vlerësuar se:

i) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

ii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.

iii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.

iv) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

95.1. Për sa më sipër, sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale.

SEANCA DËGJIMORE

96. Në datat 6 dhe 10.7.2023, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Enklid Gjini, në përfundim të së cilës ai kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisioneren Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit dhe administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Enklid Gjini, si dhe shpalli vendimin në datën 10.7.2023 sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

97. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi u është përgjigjur me korrektesë dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime/deklarime në mënyrë shteruese për informacionin e kërkuar bazuar në dokumente shkresore, të cilat kanë qenë konsistente dhe në koherencë të plotë me deklaratimet ndër vite dhe atë *Vetting*, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

⁸⁷ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.6.2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.6.2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në dosjen e Komisionit.

98. Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit sipas pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Enklid Gjini ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit Enklid Gjini ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Enklid Gjini ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Enklid Gjini, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 10.7.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE (kundër)
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Gledis Hajdini